# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6385
E enjte, 12 gusht 2021
çmimi 0.40 €



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Eksperti amerikan: Kurti duhet ta dëgjojë ShBA-në dhe t'i normalizojë raportet me Serbinë FAQE 3




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


ËSHTË MBAJTUR MBLEDHJA E QEVERISË SË KOSOVËS FAQE 4-5

# MIRATOHET STRATEGJIA PËRMES SË CILËS SYNOHET KTHIMI I BESIMIT NË DREJTËSI



Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026. Përmes kësaj strategjie ekzekutivi synon kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë dhe të sigurisë. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se me këtë dokument identifikohen problemet e këtyre institucioneve. Ajo ka treguar se pas zbatimit të kësaj strategjie, radhën e ka procesi i vettingut. Miratimin e kësaj strategjie e ka mirëpritur edhe shoqëria civile

SHTOHEN RASTET ME COVID NË KOSOVË, 3 489 RASTE AKTIVE

# Një i vdekur dhe 888 raste të reja me Covid në Kosovë



Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit është regjistruar edhe një viktimë nga koronavirusi. Sipas njoftimit të kësaj ministrie, nga 6 086 testime, pozitivë me Covid-19 kanë dalë 888 persona. Në 24 orët e fundit janë dhënë 16 905 doza të vaksinës kundër Covid-19. Rritja e rasteve të reja me Covid ka nxitur edhe kritikat e zyrtarëve opozitarë kundër qeverisë

## OPINION

### 'PËR MËMËDHENË' PËRBALLË 'KALLASHNIKOV' DHE 'NACIONALISTËT' PËRBALLË KOZMOPOLITANËVE! F. 3

Shkruan:
Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA



## AKTUALE



### KGJK: DEKLARATAT E MINISTRES HAXHIU S'I KONTRIBUOJNË BASHKËPUNIMIT TË INSTITUCIONEVE F. 5

### GRATË NË POLITIKË NUK I PËRKRAH AS PARTIA E AS SHOQËRIA F. 7

### POLICIA E KOSOVËS KA ARRESTUAR 20 PERSONA TË DYSHUAR PËR ZJARRVËNIE F. 5

## EKONOMI

### INTERESIMI PËR TË INVESTUAR NË BONOT E DIASPORËS KA ARRITUR NË 7 MILIONË EURO F. 8

### NDAHEN 5 MILIONË EURO PËR PAGESËN E POLISËS KUFITARE PËR MËRGIMTARËT F. 8

## SPORT

### LIONEL MESSI, LOJTAR I PSG-SË: ËNDËRROJ TA FITOJ LIGËN E KAMPIONËVE F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Në Shqipëri vazhdojnë përpjekjet për shuarjen zjarreve



TIRANË, 11 GUSHT (ER) - Në Shqipëri janë duke vazhduar përpjekjet për shuarjen zjarreve. Zjarret dolën jashtë kontrollit duke u përhapur në zonën pyjore mbi tunelin e Kalimashit, pjesë e Rrugës së Kombit që lidh Shqipërinë me Kosovën, duke rrezikuar lëvizjen e automjeteve dhe udhëtarëve nëpër këtë aks të rëndësishëm rrugor.

Njësitë zjarrfikëse, të mbështetura nga forcat e ushtrisë, po vazhdojnë të punojnë në shuarjen e zjarreve në malin e Rrunës, një zonë e bashkisë së Kukësit, për të mbrojtur jetët e banorëve dhe banesat e Shëmrisë. Forcave dhe mjeteve zjarrfikëse dhe atyre të ushtrisë të martën iu bashkuan edhe zjarrfikës nga Kosova si dhe një grup i Forcave të Sigurisë së Kosovës, që arritën për ndihmë gjatë natës në Kukës me urdhër të presidentes së Kosovës si dhe ministrit të Mbrojtjes së Kosovës.

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi, ka thënë se pas largimit të rrezikut nga tuneli i Kalimashit, puna është përqendruar në zonën e Malit të Rrunës, ku vatrat e zjarrit, të shfaqura prej më shumë se një jave, tashmë po përparojnë drejt zonave të banuara. "Gatishmëria është e lartë. Kjo ka bërë që ditën e djeshme të shmanget rreziku dhe tuneli të funksionojë normalisht pa ndaluar asnjë minutë. Sot, siç e shikoni, situata është shumë më e qetë dhe është vënë nën kontroll. Flakët janë larguar shumë nga tuneli. Kemi trupa të shumta që po punojnë. Tani punohet dhe nga toka", ka thënë Peleshi.

Ndërsa drejtori i Emergjencave Civile të Shqipërisë, Haki Çako, ka thënë se në bashkëpunim me forcat e ardhura nga Kosova, po punohet në Malzi të Kukësit për t'i shmangur zjarret drejt qendrave të banuara.

Prej më shumë se tre javësh zjarret vazhdojnë të kërcënojnë zona të ndryshme nga jugu në veri të Shqipërisë, përfshirë edhe zonat e banuara si dhe zonat e mbrojtura natyrore.

# Biden nuk është penduar për tërheqjen e trupave nga Afganistani

UASHINGTON, 11 GUSHT - Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se nuk pendohet për vendimin e tij që t'i tërheqë trupat ushtarake nga Afganistani teksa talibanët vazhdojnë ta rritin kontrollin. Biden u ka bërë thirrje liderëve në Afganistan që të bashkohen dhe të luftojnë "për kombin e tyre". Dhuna është përshkallëzuar në këtë shtet tani që forcat e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara janë duke u tërhequr nga Afganistani, pas 20 vjetëve të operacioneve ushtarake.

Talibanët kanë fituar kontrollin e të paktën tetë nga 34 kryeqytetet e provincave dhe janë duke kërcënuar për më shumë.

Duke folur para gazetarëve në Shtëpi të Bardhë, Biden ka thënë se ShBA-ja është duke zbatuar përkushtimet që ka bërë për Afganistanin, përfshirë mbështetjen ajrore, pagat për ushtri si dhe sigurimin e ushqimit dhe pajisjeve për forcat afgane.

"Ata duhet të luftojnë për veten e tyre", ka thënë Biden.

E përditshmja amerikane "The Washington Post" ka cituar zyrtarë të paidentifikuar të kenë thënë se kryeqyteti i Afganistanit, Kabuli, mund të bie në duart e talibanëve brenda 90 ditëve.

Më shumë se 1 000 civilë janë vrarë si pasojë e luftimeve të ashpra në mes të talibanëve dhe forcave qeveritare muajin e kaluar, kanë raportuar Kombet e Bashkuara. Agjencia për fëmijë e OKB-së, UNICEF, ka paralajmëruar këtë javë se mizoritë ndaj fëmijëve po rriten "ditë pas dite".

Forcat e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara kanë rrëzuar talibanët nga pushteti në tetor të vitit 2001. Talibanët kanë qenë duke strehuar atëbotë Osama Bin Laden dhe figura të tjera të Al-Kaidës, të lidhura me sulmet e 11 shtatorit të po atij viti në Shtetet e Bashkuara.

Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se tërheqja amerikane tani është e arsyeshme, pasi forcat amerikane janë siguruar që Afganistani nuk do të bëhet më bazë për xhihadistë të huaj që të kryejnë komplote kundër Perëndimit.



# ShBA-ja emëron këshilltar për zbatim të Marrëveshjes Rrjedha Veriore 2



Uashington, 11 gusht - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka emëruar ish-diplomatin Amos Hochstein, si këshilltar i lartë në çështje të sigurisë, me fokus në "zvogëlim të rreziqeve" nga gazsjellësi Rrjedha Veriore 2, si dhe për mbështetje të sigurisë energjetike në Evropën Lindore.

Ky vendim shpërfaq vendosmërinë e Uashingtonit për ta "kundërshtuar përdorimin e energjisë nga Kremlini si armë gjeopolitike" dhe për të nxitur një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme për Ukrainën, anëtarët e NATO-s dhe Bashkimin Evropian, ka thënë Blinken përmes një deklarate më 10 gusht.

Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara kanë arritur marrëveshje për Rrjedhën Veriore 2, në korrik të këtij viti, duke iu dhënë fund mospajtimeve për projektin pothuajse të kompletuar që mundëson dërgimin e gazit natyror të Rusisë në Gjermani, nën Detin Baltik. Berlini dhe Uashingtoni janë pajtuar për ta mbështetur bashkërisht Ukrainën si dhe për ta luftuar Rusinë nëse e shfrytëzon energjinë për presion politik.

## Kina dënon një kanadez me 11 vjet burgim për spiunim

PEKIN, 11 GUSHT - Një gjykatë kineze ka dënuar biznesmenin kanadez Michael Spavor me 11 vjet burgim për spiunim. Ky rast është parë si pjesë e mosmarrëveshjeve më të zgjeruara të Kinës me Kanadanë për shkak të fatit të Meng Wanzhou, shefes financiare të kompanisë kineze, "Huawei", e cila aktualisht është duke luftuar ekstradimin nga Kanadaja në Shtetet e Bashkuara.

Spavor është arrestuar në dhjetor të vitit 2018, në periudhën e njëjtë kur kanadezi tjetër, Michael Kovrig, ka qenë në mbajtje për supozime të ngjashme për spiunim.



EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

SHTOHEN RASTET ME COVID NË KOSOVË, 3 489 RASTE AKTIVE

# Një i vdekur dhe 888 raste të reja me Covid në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit është regjistruar edhe një viktimë nga koronavirusi. Sipas njoftimit të kësaj ministrie, nga 6 086 testime, pozitivë me Covid-19 kanë dalë 888 persona. Në 24 orët e fundit janë dhënë 16 905 doza të vaksinës kundër Covid-19. Rritja e rasteve të reja me Covid ka nxitur edhe kritikat e zyrtarëve opozitarë kundër qeverisë



"Epoka e re"

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë regjistruar 888 raste të reja të infektimit me Covid-19. Në njoftimin për media, kjo ministri ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore është raportuar edhe një rast i vdekjes. "Nga 6 086 testime, 888 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar 1 rast i vdekjes. Sot janë shëruar 38 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 881. Në total numri i rasteve aktive është 3 489", është thënë në njoftimin e ministrisë.
Gjithashtu, ministria ka treguar edhe për numrin e vaksinave që janë dhënë në 24 orët e fundit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 16 905 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 521 737 doza të vaksinës. Deri më sot 174 991 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", është thënë në njoftimin e ministrisë.
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka bërë me dije në raportin e 11 gushtit se 186 pacientë janë të shtrirë në klinikat ku trajtohen pacientët me Covid-19. Prej këtij numri, 136 pacientë janë të konfirmuar pozitivë me koronavirus. Dy prej tyre janë në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërkaq 117 të tjerë po trajtohen me oksigjenoterapi.

### Opozita kritikon qeverinë për keqmenaxhim të pandemisë

Rritja e rasteve të reja me Covid ka nxitur edhe kritikat e zyrtarëve opozitarë kundër qeverisë. Anëtari i kryesisë i PDK-së, Betim Gjoshi, ka bërë përgjegjës ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, për keqmenaxhim të pandemisë. "Dje 562 raste, sot 888. Keqmenaxhimi me pandeminë po na çon në greminë. Nëse do të ishte kaq i interesuar dhe i shqetësuar për shëndetin e qytetarëve, Arben Vitia do t'i përkushtohej vetëm detyrës që ka marrë. Por, jo! Vitia po e lë shëndetin e qytetarëve buzë greminës dhe do t'u përkushtohet zgjedhjeve për Prishtinë. Asnjë doktor i vërtetë nuk do ta braktiste shëndetin e qytetarit", ka shkruar ai në profilin e vet në "Facebook".
Edhe deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka kritikuar qeverinë Kurti se nuk po e menaxhon si duhet situatën me pandeminë. Në profilin e saj në "Facebook", ajo ka shkruar se qeveria thoshte se po menaxhohet pandemia në kohën kur virusi po shpërndahej më pak. "E thanë që e menaxhuan pandeminë kur numrat ranë e virusi shpërndahej më pak. Dje 562 raste të reja, sot 888 dhe, si për ironi, LV-ja lëshon informata se ka vendosur që në Prishtinë ta kandidojë Arben Vitinë, po pra ministrin e Shëndetësisë. Kaq brengoset kjo qeveri për qytetarët, i sheh si vota dhe asgjë më shumë", ka shkruar Bajrami.
Për më pak se një muaj janë rritur për dhjetëra herë shifrat e rasteve aktive me Covid në Kosovë.
Nga 98 raste sa ishin më 17 korrik, shifra është ngritur në 3 489 të mërkurën e 11 gushtit. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 111 644 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 274 kanë vdekur.

# Eksperti amerikan: Kurti duhet ta dëgjojë ShBA-në dhe t'i normalizojë raportet me Serbinë

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Eksperti amerikan për politikën dhe çështjet e Lindjes së Mesme, Alon Ben-Meir, i ka bërë thirrje kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që t'i dëgjojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të bëjë përpjekje për t'i normalizuar marrëdhëniet me Serbinë.
Ben-Meiri ka theksuar se Kurti duhet të tregojë se po bën atë që mundet dhe të bëjë presion mbi Serbinë. Sipas ekspertit amerikan të çështjeve politike, nëse kryeministri i Kosovës bën këtë, do të fitojë mbështetje shumë më të madhe nga Perëndimi-Shtetet e Bashkuara, BE-ja dhe vendet e tjera. "Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duhet t'i dëgjojë Shtetet e Bashkuara dhe të bëjë çdo përpjekje për të normalizuar çdo lloj marrëdhënieje me Serbinë. Ai duhet të tregojë se po bën atë që mundet, dhe të bëjë presion dhe barrë mbi Serbinë. Nëse e bën këtë, ai do të fitojë një mbështetje shumë më të madhe nga Perëndimi – Shtetet e Bashkuara, BE-ja dhe vendet e tjera – dhe kjo do të shtrëngojë në mënyrë indirekte Serbinë. Kjo është ajo që duhet bërë në mënyrë që të ecë përpara procesi dhe të rritet. Me të gjitha këto masa, unë absolutisht besoj se përfundimisht Kosova do të integrohet në BE", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook".
Alon Ben-Meir është një ekspert amerikan në politikën dhe çështjet e Lindjes së Mesme, i specializuar në negociatat e paqes midis Izraelit dhe shteteve arabe.





ËSHTË MBAJTUR MBLEDHJA E QEVERISË SË KOSOVËS

# Miratohet strategjia përmes së cilës synohet kthimi i besimit në drejtësi

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026. Përmes kësaj strategjie ekzekutivi synon kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë dhe të sigurisë. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se me këtë dokument identifikohen problemet e këtyre institucioneve. Ajo ka treguar se pas zbatimit të kësaj strategjie, radhën e ka procesi i vetting-ut. Miratimin e kësaj strategjie e ka mirëpritur edhe shoqëria civile

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 GUSHT - Qeveria e Kosovës të mërkurën ka miratuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026. Aprovimi i këtij dokumenti është vlerësuar si hapi më i rëndësishëm i qeverisë Kurti në fushën e sundimit të ligjit.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije kjo strategji ka për synim ta arrijë kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë. "Momentin që është votuar qeveria Kurti jemi zotuar për sundim të ligjit, për kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, sepse këtë e kemi problemin më të madh në Kosovë, pra humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë", ka thënë ajo në një konferencë për media pas mbledhjes së qeverisë. Sipas saj, me këtë dokument identifikohen problemet e sistemit të drejtësisë dhe rekomandohet se si mund të zgjidhen ato. "Ky dokument është nga dokumentet më të rëndësishme për sundimin e ligjit, pasi përmes këtij procesi janë identifikuar problemet e institucioneve të drejtësisë, po ashtu edhe të institucioneve të sigurisë. Më tutje, janë dhënë rekomandime sesi do të adresohen ato dhe si të eliminohen problemet që i kemi në institucionet e drejtësisë dhe sigurisë", ka vlerësuar Haxhiu, duke treguar objektivat e kësaj strategjie.

"Strategjia përbën objektiva strategjike që ndërlidhen me fuqizimin e gjyqësorit, por dhe të prokurorisë, fuqizimin e drejtësisë penale, fuqizimin e qasjes në drejtësi dhe fuqizimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", është shprehur ajo.

Më tej, ajo ka treguar se sfida më e madhe është zbatimi i këtij dokumenti. "Puna më e madhe do të jetë tani, sepse ne si ministri e drejtësisë e kemi obligim monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie. Këtu do të jemi në bashkëpunim të plotë sikurse kemi qenë deri tani, me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, Policinë e Kosovës", ka thënë ajo.

## IKD-ja mirëpret miratimin Strategjisë për sektorin e sundimit të ligjit

Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, e ka mirëpritur veprimin e qeverisë për ta miratuar Strategjinë për sektorin e sundimit te ligjit. Ai ka vlerësuar se ky është vendimi më përmbajtjesor që ka marrë qeveria Kurti. "Vendimi më i mirë dhe më përmbajtjesor që ka marrë qeveria Kurti që nga formimi i saj është miratimi i Strategjisë për Sektorin e Sundimit të Ligjit. Vetëm vullneti politik, koordinimi dhe bashkëpunimi institucional për zbatimin e kësaj strategjie mund të bëjë ndryshimin, mund ta kthejë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, mund të kemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm dhe mund të kemi shpresë se do të luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni", ka shkruar Miftaraj në profilin e tij në "Facebook". Sipas tij, me këtë vendim duhet të ndihen krenarë të gjithë ata që kanë kontribuuar në për hartimin e këtij dokumenti. "Lajm i jashtëzakonshëm. Sot me këtë vendim duhet të jenë krenarë të gjithë ministrat e drejtësisë që kanë punuar në këtë strategji në pesë vjetët e fundit, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë ndihmuar Ministrinë e Drejtësisë", ka shkruar ai.

### Ende nuk është vendosur si do të bëhet vettingu

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka treguar se pas zbatimit të kësaj strategjie, radhën do ta ketë procesi i vetting-ut në fushën e drejtësisë. Ajo ka thënë se kjo ministri ende nuk ka vendosur për skenarin me të cilin do të bëhet procesi i vettingut në sistemin e drejtësisë.

Haxhiu ka treguar se janë duke punuar me intensitet që të bëhet vetting-u, duke shtuar se ky proces është kërkesë shoqërore. “Ende nuk kemi vendosur se cilin skenar do ta ndjekim, por nëse nuk shkojmë me ndryshime kushtetuese, do ta kemi edhe planin B, që nëse në Kuvendin e Kosovës dështojnë ndryshimet kushtetuese, ta kemi edhe planin B përmes ndryshimeve ligjore. Kemi thënë se jemi duke punuar me ekspertë që të mos bëjmë ndonjë gabim në këtë drejtim”, ka deklaruar Haxhiu.

E para e drejtësisë ka bërë me dije se shumë shpejt do të dalin me skenarin për vetting. Sipas saj, për këtë proces duhet të ketë konsensus politik. “Besoj që shumë shpejt do të dalim me skenarin dhe në këtë drejtim unë mendoj se është i rëndësishëm edhe konsensusi politik, gjegjësisht planifikoj që shumë shpejt t’i takoj edhe grupet e tjera parlamentare, në mënyrë që ta kemi mbështetjen e tyre për një proces që është shumë i rëndësishëm dhe në shërbim të qytetarëve”, ka deklaruar Haxhiu.

## Emërohet komisioni qeveritar për njohjen e statutit të ish-të dënuarve dhe ish-të përndjekurve politikë

Në mbledhjen e së mërkurës qeveria ka miratuar propozimin e Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të ish-të Dënuarve dhe ish-të Përndjekurve Politikë. Anëtarë të këtij komisioni do të jenë: Fadil Bunjaku, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Petrit Shala, përfaqësues nga Ministria e Financave, Isak Shabani, përfaqësues nga MSh-ja, Hydajet Hyseni-“Kaloshi” përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës, Berat Luzha, përfaqësues nga Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Mazllum Baraliu, përfaqësues nga Shoqata e Juristëve të Kosovës. Po ashtu, qeveria ka aprovuar katër vendime për ndarjen e mjeteve për zbatimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Sipas vendimit të qeverisë, 17 milionë euro janë ndarë për mbështetje për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale, 3 milionë për subvencionim të tarifave të garancisë së Fondit për Garanci Kreditore, 5 milionë përkrahje sportit dhe kulturës, 5 milionë për mbulimin e kostos së polisës kufitare për të gjithë bashkatdhetarët, si dhe 247 000 mijë euro për blerje të veprave të artistëve të Kosovës. Me qëllim avancimin e mëtejmë të procesit të integrimit të Kosovës në BE, qeveria ka miratuar edhe Planin e Veprimit ERA II.

# Policia e Kosovës ka arrestuar 20 persona të dyshuar për zjarrvënie

**Prishtinë, 11 gusht (ER)** - Policia e Kosovës ka njoftuar për veprimet që ka ndërmarrë për parandalimin dhe hetimin e rasteve të ndryshme penale që ndërlidhen me zjarret. Përmes një komunikate për media policia ka treguar se nga muaji qershor i këtij viti deri më 10 gusht janë arrestuar gjithsej 20 persona të dyshuar të përfshirë në këto vepra. “Nga muaji qershor i këtij viti (2021) deri dje (10.08.2021) janë evidentuar: 109 raste të zjarrvënieve, 71 raste të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm dhe 95 incidente zjarri, duke shkaktuar kështu rrezik për jetën e qytetarëve, por edhe pronën në përgjithësi, si atë private dhe shtetërore. Lidhur me rastet e sipërcekura nga Policia e Kosovës janë iniciuar procedura penale dhe janë identifikuar 41 të dyshuar, si dhe janë arrestuar gjithsej 20 njëzet persona të dyshuar të përfshirë në to”, është thënë në njoftimin e policisë.

Policia e Kosovës ka falënderuar qytetarët për bashkëpunimin për identifikimin e këtyre rasteve. “Gjatë kësaj periudhe falënderojmë qytetarët dhe institucionet e tjera për bashkëpunimin dhe ndihmën e ofruar në funksion të identifikimit të shpejtë të incidenteve të zjarrit, parandalimit të rasteve të tjera të rrezikut të përgjithshëm dhe shpërndarjen e informacioneve lidhur me vetëdijesimin për rrezikun potencial që mund të vijë nga veprimet e pakujdesshme të disa personave”, është thënë në njoftim.



# KGjK: Deklaratat e ministres Haxhiu s’i kontribuojnë bashkëpunimit të institucioneve

**Prishtinë, 11 gusht (ER)** - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) i ka reaguar ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila e ka kritikuar këtë institucion. Përmes një komunikate dërguar mediave, KGjK-ja ka thënë se reagimet e ministres Haxhiu nuk i kontribuojnë bashkëpunimit të institucioneve. “Reagimet dhe deklarata e ministres Haxhiu nuk i kontribuojnë bashkëpunimit të institucioneve sepse përgjegjësitë e institucioneve për komunikim dhe bashkëpunim përcaktohen me kushtetutë dhe ligj, dhe jo nga vullnetet personale. Përndryshe, KGjK ka mekanizmat e vet për adresimin e secilës çështje që është përgjegjësi e KGjK-së, andaj çfarëdo përpjekje nga jashtë, përfshirë edhe deklaratat e ministres Haxhiu, janë pa ndikim në mënyrën se si funksionon ky këshill”, është në komunikatën e KGjK-së.

Gjatë ditës, në një konferencë për media, Haxhiu ka thënë se nuk do t’i mbështesë KPK-në dhe KGjK-në nëse këto institucione mbyllin sytë përballë skandaleve. “Unë nuk dua t’i mbështes këto këshille kur duan t’i mbyllin sytë përballë skandaleve. Në momentin kur nuk ka reagime si ajo e incizimeve, natyrisht që do të kritikohen nga Ministria e Drejtësisë. Edhe sot paralajmëroj Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial nëse nuk duan të punojnë bashkërisht për kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë”, ka thënë Haxhiu.



## Haziri: Në Gjilan kemi krijuar balancë investimesh qytet-fshat



**Gjilan, 11 gusht (ER)** - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka deklaruar se gjatë mandatit qeverisës kanë vendosur balancë investimesh qytet-fshat. Kreu i Gjilanit ka thënë se kjo formulë e investimeve mbi parimin e barazisë ka qenë synim i tij të cilin e ka realizuar. "Nuk dua të flas për realizimin e programeve të mëdha për Gjilanin sepse ato janë të dukshme. Ajo që më bën të ndihem mirë është se gjatë qeverisjes katërvjeçare kemi vendosur balancë investimesh qytet-fshat. Ky ka qenë synimi im dhe ndihem mirë që e kemi arritur këtë", ka thënë Haziri.

# Komuna e Malishevës mbajti mbledhje përkujtimore për nder të Ragip Kastratit



**Malishevë, 11 gusht (ER)** - Të martën ka ndërruar jetë zyrtari në Drejtorinë e Administratës-Gjendjes Civile, Ragip Kastrati nga fshati Turjakë, ndërkaq të mërkurën, në nderim të tij, komuna e Malishevës ka mbajtur një mbledhje përkujtimore, ku janë shprehur ngushëllimet për familjet, miqtë dhe shokët e tij dhe është kujtuar jeta dhe puna e tij në shërbim të qytetarëve. "Dita e djeshme ishte jo e zakonshme për të gjithë ne, pasi morëm lajmin për vdekjen e zyrtarit Ragip Kastrati, por as dita e sotme nuk ishte e zakonshme, pasi vërehej mungesa e tij në punë. Ragipi ishte një punëtor i disiplinuar dhe i përgjegjshëm karshi detyrave dhe obligimeve. Jemi pjesëmarrës në dhimbjen e familjes Kastrati dhe në emër të komunës së Malishevës, në emër të kryetarit Ragip Begaj dhe në emrin tim personal, i shprehim ngushëllimet më të thella familjes, miqve dhe bashkëpunëtorëve", ka thënë nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha.

Ndërsa për drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës, Besartë Kryeziu-Ramaj, vdekja e Ragip Kastratit ishte lajm shokues dhe pikëllues. "Ai ishte punëtor i zellshëm dhe bashkëpunues e i dashur me të gjithë", ka thënë Berisha.

# Shënohet 23-vjetori i Ditës së Dëshmorëve të Kaçanikut

**Kaçanik, 11 gusht (ER)** - Nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Kaçanikut janë mbajtur disa aktivitete për shënimin 10 Gushtit - Ditës së Dëshmorëve të Brigadës 162 "Agim Bajrami".

Aktiviteti kryesor është mbajtur në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj" përmes një akademie përkujtimore, ku janë përkujtuar dëshmorët e komunës së Kaçanikut. Me këtë rast kryetari i komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka thënë se 10 gushti mbetet një ditë historike për komunën e Kaçanikut, ngaqë më 10 gusht 1998 dolën krismat e para çlirimtare në anën e Kaçanikut, ku edhe ranë heroikisht komandant Agim Bajrami, me bashkëluftëtarët Besnik Begunca e Xheladin Kurtaj. "10 gushti mbetet dita e përkujtimit të dëshmorëve dhe të gjithë të rënëve në komunën e Kaçanikut. Kjo ditë na kthen kujtesën tonë historike 23 vjet më parë, për të kujtuar ngjarjen që më së miri portretizon dhe skalit emrat e të gjithë dëshmorëve të anës së Kaçanikut, që kishin së bashku një qëllim: lirinë e atdheut të tyre", ka thënë kryetari Ilazi.

Në emër të organizatës së veteranëve të luftës ka folur Hajrush Kurtaj, ish-zëvendës komandant i Brigadës 162 "Agim Bajrami", i cili tha se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një epokë e historisë shqiptare, ndërsa shtoi se Kaçaniku i fali kësaj toke 95 dëshmorë, dy komandantë, tri vajza të rëna nën petkun e UÇK-së dhe një nënë.





## Palestra sportive në SHMU1 do të jetë gati për nxënësit nga 1 shtatori

**Vushtrri, 11 gusht (ER)** - Kryetari i komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije të mërkurën se palestra shkollore sportive në Shkollën e Mesme të Ulët (SHMU1) në Vushtrri do të jetë gati për nxënësit dhe sportistët nga 1 shtatori.

Kryetari Tahiri ka thënë se kampionet tona olimpike në 'Tokyo2020' na vërtetuan edhe një herë sa i rëndësishëm është investimi në infrastrukturën sportive. "Besojmë fort në olimpistët e rinj të Vushtrrisë e të Kosovës, prandaj dy palestra të tilla po i bëjmë në qytet", ka thënë Tahiri.

# Gratë në politikë nuk i përkrah as partia e as shoqëria




PRISHTINË, 11 GUSHT - Që nga viti 1999 në Kosovë vetëm një komunë është udhëhequr nga një grua. Në vitin 2013 Mimoza Kusari-Lila kishte fituar garën për ta udhëhequr komunën e Gjakovës. Që nga ajo kohë partitë politike kanë kandiduar kryesisht burra dhe asnjë grua nuk arriti ta fitonte garën për të udhëhequr ndonjë komunë.

Në dy palë zgjedhjet e fundit lokale, ato të vitit 2017 dhe 2013, partitë politike kishin kandiduar vetëm 17 gra për kryetare të komunave nga rreth 450 kandidatë.

Sipas një raporti të Institutit Demokratik të Kosovës, përfaqësimi i grave në dy palë zgjedhjet e fundit lokale ka qenë tejet i ulët edhe gratë si bartëse të listave për Asamble komunale. "Nga mbi 400 lista të dorëzuara pranë KQZ-së (Komisionit Qendror të Zgjedhjeve) nga subjektet politike në dy palë zgjedhjet e fundit lokale (2017 dhe 2013), vetëm më pak se 1 për qind e tyre (38 gjithsej) kishin gra bartëse të listave", thuhet në raport.

## A do të kandidojnë gra partitë politike?

Ndonëse janë afruar zgjedhjet e 17 tetorit, në këtë pyetje ka qenë e vështirë të merret përgjigje nga partitë kryesore politike në Kosovë, përfshirë partinë në pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje, si dhe partitë opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës si dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Zyra për informimin në Lëvizjen Vetëvendosje ka thënë se në ditët në vijim do të konfirmohen emrat e kandidatëve për kryetarë të komunave dhe se pastaj do të bëhen publikë për opinionin.

Deri më tani vetëm Lidhja Demokratike e Kosovës publikisht ka njoftuar se ka kandiduar dy gra për zgjedhjet lokale. Hyrie Dobrunaj do të garojë për kryetare të komunës së Deçanit, ndërsa Sibel Halimi është kandidate e LDK-së për komunën e Ferizajt.

"Radio Evropa e Lirë" ka biseduar me Halimin që, po ashtu, mban edhe pozitën e zëdhënëses së partisë, por ajo ka thënë se e ka të pamundur të përgjigjet.

Ndërkaq, në një përgjigje të shkruar, nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, thotë se udhëheqësia e re e këtij subjekti politik është e përkushtuar që gratë dhe të rinjtë të kenë edhe më shumë hapësirë në vendimmarrje. "Jemi duke diskutuar me gra të shumta që janë rritur organikisht me PDK-në, por edhe me zonja që po i bashkohen PDK-së, që t'ua krijojmë hapësirën e merituar dhe të garojnë për kryetare komunash, bartëse të listave dhe natyrisht në listat për asamble komunale", thotë Çitaku.

Në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës thonë se kanë biseduar me shumë gra. Por, sipas deputetes së këtij subjekti politik, Time Kadriaj, shumë prej tyre kanë refuzuar që të marrin përgjegjësi. "Faktikisht, ne i kemi thënë disa propozime dhe shumicën e rasteve që nuk po i bëjmë publike, kanë hezituar të marrin përgjegjësi", thotë Kadriaj. Ajo tregon se ende nuk është vendosur për të gjithë emrat dhe se AAK-ja mund të ketë edhe gra kandidate për të udhëhequr ndonjë komunë.

## Kusari-Lila: Shumica e grave nuk gjejnë hapësirë e disa refuzojnë vetë

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ish-kryetarja e Gjakovës, tani deputete në Kuvendin e Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, thotë se mungesa e grave në vendimmarrje, përveç se është problem politik, është problem edhe shoqëror.

Kusari-Lila, që është gruaja e vetme që ka qenë kryetare komune, thotë se, përveç partive politike, e gjithë shoqëria duhet të angazhohet më shumë për përfshirjen e grave në vendimmarrje. Ajo thotë se një numër i madh i grave nuk gjejnë hapësirë nëpër subjekte politike përkundër faktit se kanë përgatitje të mjaftueshme profesionale por, sipas saj, ka edhe gra në politikë që hezitojnë të garojnë për të udhëhequr ndonjë komunë. "Ka mjaftueshëm gra në kuadër të subjekteve politike, të cilave edhe pse u janë ofruar mundësitë për kandidimin e të parës së komunës, kanë refuzuar. Aq sa kam njohuri, kjo ka ndodhur në disa subjekte për arsye se pozita e kryetarit të komunës konsiderohet me një kompleksitet pak më të gjerë dhe me një gamë të sfidave më të mëdha sesa në pozita të nivelit qendror apo legjislativ", thotë Kusari-Lila.

Përveç në zgjedhje lokale, edhe në ato të përgjithshme, numri i grave në lista të subjekteve politike mbetet i ulët. Ligji për Barazi Gjinore parasheh që 50 për qind të jenë burra si dhe 50 gra. Por, në zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit, në listat e partive gra ishin vetëm 30 për qind.

## Cakolli: Barazia gjinore, koncept i panjohur për partitë

Eugen Cakolli, hulumtues politikash në Institutin Demokratik të Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se partitë politike në të shumtën e rasteve respektojnë kriteret minimale për përfshirjen e grave në lista zgjedhore. Sipas tij, partitë përpiqen ta respektojnë minimalisht Ligjin për Zgjedhje, i cili parasheh që të paktën 30 për qind e listës së partive në komunat ku ato garojnë, duhet të jenë të përbëra nga gratë. "Gratë kanë tradicionalisht trende më të larta të daljes në zgjedhje lokale sesa që kanë burrat. Një pjesë të fajit e kanë vetë votuesit, sidomos gratë, të cilat nuk i kanë ndëshkuar me votë subjektet politike të cilat nuk kanë përfshirë në radhët e tyre numër të barabartë të grave dhe të cilat nuk kanë kandiduar gra për të parin e komunës", thotë Cakolli. Sipas Cakollit, shumica e subjekteve politike në procese zgjedhore anashkalojnë Ligjin për Barazi Gjinore, i cili e përcakton barazinë gjinore si situatë ku të dyja gjinitë janë të përfaqësuara në raportin 50-50.

## Gratë janë më të përfaqësuara në rajon

Gjendje më e mirë e përfaqësimit të grave në pushtetin lokal është në shtetet e rajonit. Nga 61 bashki sa ka Shqipëria, tetë prej tyre udhëhiqen nga gratë. Në Serbi janë 169 pushtete lokale dhe prej tyre, 22 udhëhiqen nga gratë. Nga 34 komuna sa ka gjithsej Maqedonia e Veriut, gjashtë gra mbajnë pozitën e kryetares.

Në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2020 që u mbajtën në Bosnje dhe Hercegovinë, nga 142 pozita udhëheqëse, vetëm tri gra u zgjodhën në pozitën e kryetares së komunës.

Në Mali të Zi, prej 24 komunave, vetëm dy udhëhiqen nga gratë.

Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, pjesëmarrja dhe udhëheqja e barabartë e grave në jetën politike dhe publike janë thelbësore për arritjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm deri në vitin 2030. "Me ritmin aktual, barazia gjinore në pozicionet më të larta të pushtetit nuk do të arrihet për 130 vjet të tjera", thuhet në një raport të publikuar nga OKB-ja këtë vit. Sipas OKB-së, të dhënat tregojnë se gratë janë të nënpërfaqësuara në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në mbarë botën dhe arritja e barazisë gjinore në jetën politike është larg.

# ‘Për Mëmëdhenë’ përballë ‘Kallashnikov’ dhe ‘nacionalistët’ përballë kozmopolitanëve!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Dy skaje të papërputhshme:** “Për Mëmëdhenë”, këngë e shkruar nga shqiptari i vërtetë, patrioti, trimi dhe korçari Mihal Grameno, ishte dhe mbeti frymëzim i shumë gjeneratave që luftuan dhe u shkrinë për liri dhe bashkim kombëtar. Nuk ka këngë më motivuese dhe frymëzuese e që është bashkëdyzim dhe mishërim i ndjenjave më fisnike kombëtare. E kënduan edhe luftëtarët e Shaban Polluzhës në luftë kundër baballarëve politikë të Aleksandër Vuçiqit, Edi Ramës dhe Mustafa Nanos dhe ca horrave të tjerë që po identifikohen si kozmopolitanë, kurse ne që këngën “Për Mëmëdhenë” e kemi himn shpirtëror, jetësor dhe ekzistencial, na quajnë “patriotë” primitivë. Më herët lloji i kryebashkiakut të Korçës së sotme e që kanë jetuar në kohë të tjera skajshmërisht e kanë injoruar Mihal Gramenon, ndërsa sot me kozmopolitizmin e njësuar me Aleksandër Vuçiqin dhe Goran Bregoviqin, po e vrasin për së dyti, patriotin e madh shqiptar Mihal Grameno, duke e çiftëzuar promovimin e një shovinizmi serbomadh me një aktivitet artistik siç është Mbrëmja e Birra Korçës.

Goran Bregoviq ishte alfa dhe omega e rok grupit “Bijello Dugme” në ish-Jugosllavi. Pas shpërndarjes së këtij grupi e filloi një solo karrierë, por tani me një theks të veçantë duke promovuar kulturën rome përmes interpretimit orkestral. Kur nisi shkapërderdhja e ish-Jugosllavisë, jetën e kaloi në Paris dhe në Beograd. Parisi, si vend dhe qytet i modës dhe kulturës botërore, Beogradi si vend dhe qytet ku u planifikua, u orkestrua dhe u zbatua gjenocidi i Serbisë kundër kroatëve, kundër myslimanëve të Bosnjës dhe kundër shqiptarëve në Kosovë. Ishte mik i ngushtë i çetnikut Emir Kusturica dhe i Radovan Karaxhiqit. Edhe Karaxhiqi ishte roker dhe shkruante poezi për t’u transformuar në një kriminel lufte. Goran Bregovoqi thoshte se Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Tereza ishte rome dhe jo shqiptare. Një kohë kam jetuar në Sarajevë, si student dhe kam takuar edhe Bregoviqin, kurse Karaxhiqi ka qenë asistent në Fakultetin e Mjekësisë, në Kliniken e Psikiatrisë. Ishte koha kur në horizont shihej shkatërrimi i federatës jugosllave dhe indikatorët më të mirë për këtë ishin ndeshjet e futbollit si dhe koncertet muzikore ku shfaqej edhe urrejtja e shtypësit (serbëve), por edhe urrejtja e të shtypurve kroatë, boshnjakë, shqiptarë dhe malazezë. Dëgjoheshin brohoritjet si çetnici, ballije, shiptari dhe ustashe. Atëherë luanim futboll të vogël në sallën e Fakultetit të Kulturës Fizike, ku ishte edhe një pishinë ku studentët e Fakultetit të Mjekësisë, sipas zgjedhjes, kishin tri orë në javë not. Kur ishte koha e mirë luanim futboll në fushat ndihmëse të stadiumit “Koshevo”, që gjatë luftës së Bosnjës u shndërruan në varreza. Davorin Popoviq - Pimpek ishte frontman i rok grupit “Indeksi”, kroat dhe nuk i fshihte, sidomos para se të vdiste, ndjenjat kombëtare. Vëllezërit Musemiq, futbollistë të njohur, ishin myslimanë dhe identifikoheshin me organizatën “Mllada Bosna” që përfaqësonte ndjenjat nacionaliste të myslimanëve të Bosnjës. Neda Ukraden, ndonëse e familjes së përzier, ishte serbomadhe tipike dhe krenohej me këtë. Zdravko Çolliqi dhe Goran Bregoviqi ishin hermafroditë në aspektin kombëtar dhe oportunistë, deklaroheshin sipas interesit momental dhe material. Pikërisht gjatë këtyre aktiviteteve sportive dhe ndejave në kafeterinë “Pimpek” të Davorin Popoviqit që ishte në Marijin Dvor, duke përfaqësuar dhe mbrojtur interesin kombëtar, i “fitova” tri vjet burg, i dënuar për propagandë armiqësore e që i mbajta në burgun e Sarajevës, të Foçës dhe të Mostarit, bashkë me Rexhep Malën, Skender Kastratin dhe Agim Sylejmanin, kryesisht në vetmi dhe izolim. Në një ndejë ishin edhe Vojisllav Shesheli, atëherë marksist i përbetuar dhe Rajko Petrov Nogo, serbomadh i tërbuar dhe i përbetuar. Kur më arrestuan, gjatë marrjes në pyetje kuptova se disa prej të përmendurve më lart, para hetuesve të UDB-së më kishin cituar dhe në këtë mënyrë kishin kontribuar për dënimin tim. Unë flisja hapur dhe e mbroja atë që e thosha. Është interesant që disa prej tyre apo shokë të tyre i pata takuar në burgun e Mostarit (Jadranko Topiq, kroat, futbollist i Velezhit dhe kombëtares jugosllave sepse kishte kënduar këngë ustashe), Ipe Ivandiq, daullist i rok grupit “Bijello Dugme” ishte në Burgun e Foçës dhe gjithashtu në burgun e Foçës e pata takuar boshnjakun (më ka ikur emri i tij), që e vrau në Pale të Jahorinës krushkun serb e që serbët e shfrytëzuan si pretekst për ta filluar luftën në Bosnjë.

“Kallashnikov” është këngë identifikuese e përcaktimit njerëzor, politik, kombëtar dhe kulturor i Goran Bregoviqit. Krejtësisht e kundërta me këngën e Mihal Gramenos. Kallashnikov është armë automatike e projektuar me urdhër të Stalinit nga Mihal Kallashnikovi, inxhinier rus e që arriti sukses të madh gjatë Luftës së Dytë Botërore. Po kjo armë është përdorur dhe keqpërdorur thuaja nga të gjitha regjimet shtypëse në Afrikë, Amerikën e Jugut, nga organizatat terroriste dhe ato mafioze. Nga kjo armë janë vrarë me dhjetëra dhe qindra milionë njerëz.

Kush e ka dëgjuar këngën “Kallashnikov”, lehtësisht e ka të qartë se teksti nuk ka të bëjë asgjë me kulturën, humanizmin apo tolerancën. Është pikërisht e kundërta, aty ka urdhra ushtarake dhe policore që për qëllim kanë vrasjen e atyre që i konsiderojnë armiq. Shqiptarët e Kosovës më parë, por edhe tani konsiderohen si armiq të Serbisë, prandaj gjatë historisë 150-vjeçare të gjitha përpjekjet e Serbisë dhe të serbëve ishin shfarosja e shqiptarëve. Është interesante se që nga koha e mbretit Ahmet Zogu, shqiptarët e Shqipërisë konsideroheshin dhe trajtoheshin si miq nga Nikolla Pashiqi dhe Mbretëria Serbo - Kroato - Sllovene, më vonë sidomos para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, pra në kohën e Enver Hoxhës, shqiptarët nga Shqipëria trajtoheshin si rrogëtarë të Milladin Popoviqit, Dushan Mugoshes, Tempos dhe Josip Broz Titos. Edhe tash, në kohën e absolutizmit të Edi Ramës në Shqipëri, shqiptarët konsiderohen miq nga Aleksandër Vuçiqi, Vulini dhe Ivica Daçiqi. Këtë trajtim e pranojnë me pasion të sëmurë Edi Rama dhe minjtë e tij përcjellës, Muç Nano Daija, Kulla e argjilës sikur edhe të tjerë që përjetojnë orgazëm vetëm kur të përmendet emri i Goran Bregoviqit dhe Aleksandër Vuçiq. Këta të pafytyrë nuk e kanë as ndjenjën më të vogël të solidaritetit me familjet e mbi 12 000 shqiptarëve të vrarë dhe të masakruar gjatë luftës së fundit në Kosovë, mbi 1 400 varre të hapura ku pritet të vendosen shqiptarët e marrë pengë nga krimineli Vuçiq e që janë vrarë me “Kallashnikov” të Goran Bregoviqit sikur që as që iu bënë përshtypje dhunimi i dhjetëra mijërave grave shqiptare në Kosovë. Këta të pafytyrë i dhanë kopjen e “Çelësit të Tiranës” pikërisht Goran Bregoviqit sikur që duan të organizojnë koncert të këtij krimineli artistik, Goran Bregoviq, mbi varrin e të pavdekshmit dhe të amshueshmit, korçarit dhe shqiptarit patriot dhe nacionalist, Mihal Grameno. Kur ne nuk pajtohemi me këtë, çifti i të pafytyrit, të mbuluar me mjekër na quan “nacionalistë”, nga pozita e kozmopolitit ndërkaq, dylberi me të linjta të kuqe e shpërfaq mungesën elementare të karakterit njerëzor duke deklaruar haptas se: “Është më i afërt me Goran Bregoviqin se me nacionalistët primitivë apo policë të mendimit të cilët i identifikon shqiptarët e Kosovës, kundërshtarë të koncertit mbi varre të patriotëve korçarë e që mbahen nën përkujdesjen vëllazërore të Edi Ramës dhe kryeinjorantit të Bashkisë së Korçës, kondom politik i Edi Ramës. Merreni me mend deri ku shkon magjepsja e këtyre kozmopolitanëve me Bregoviqin dhe bregoviqët kur deklaron se: “nuk e di kush është Bregoviqi, por se do të shkojë në koncert…” të organizuar nga Edi Rama dhe kryedashi i Bashkisë së Korçës mbi varret e patriotëve shqiptarë, Themistokli Gërmenji dhe Mihal Grameno. Këta horra po e bëjnë përpjekje ta vrasin serenatën e mahnitshme korçare me pordhën artistike të quajtur “Kallashnikov” të Goran Bregoviqit.

**Racizmi njerëzor, kombëtar, politik dhe kulturor ndaj shqiptarëve të Kosovës:** Që nga koha e Ahmet Zogut e deri më tani shqiptarët e Kosovës janë trajtuar nga pozita e një racizmi. Ata që janë larguar nga Kosova për të vazhduar luftën kundër Serbisë, nga mbreti Zog janë trajtuar keq dhe më keq duke u dërguar në mjedise moçalike apo, nëse e kanë kundërshtuar zogun, janë vrarë për llogari dhe sipas kërkesës së Nikolla Pashiqit, sidomos patriotët e shkolluar. Kujtojeni Hasan Prishtinën, Isa Boletinin dhe të tjerët. Gjatë regjimit komunist të Enver Hoxhës shqiptarët e ikur nga Jugosllavia janë arrestuar dhe dënuar me burgje të rënda, si të dërguar të UDB-së, pa pasur asnjë provë apo duke nxjerrë prova me dhunë brutale.

Shqiptarët e Kosovës e kanë dashur dhe e duan Shqipërinë e cila është e përjetshme në ndërkohë që këta “Kalorësit e Apokalipsit”, Ahmet Zogu, Enver Hoxha, Sali Berisha dhe Edi Rama, janë të përkohshëm. Të vdekur edhe për së gjalli. Enver Hoxha, në emër të një internacionalizmi proletar, zhveshi shqiptarët nga të gjitha vlerat që e karakterizojnë njeriun jo vetëm në planin anatomik nga vlerat njerëzore, kombëtare dhe morale dhe pikërisht Shqipëria e sotshme po korrë atë që e ka mbjellë Enver Hoxha. Edi Rama, nën maskën e një kozmopolitizmi, Aleksandër Vuçiqin, Damir Fazlliqin, Ivica Daçiqin i konsideron miq dhe vëllezër të përcaktimit, kurse Albin Kurtin dhe ata që nuk pajtohen me të i konsideron “nacionalistë primitivë”. Më të afërt e ka Vuçiqin se Albin Kurtin dhe Adem Demaçin. Vuçiqin e ka

→

## Zvogëlohen kreditë e këqija në Shqipëri



Tiranë, 11 gusht - Huat me probleme kanë shënuar rënie të ndjeshme në qershor në Shqipëri, duke dëshmuar për një përmirësim të aftësisë paguese të individëve dhe bizneseve. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, ky tregues zbriti në 7.12 për qind në fund të qershorit, ndjeshëm më poshtë se krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 kur fiksohej në 8.09 për qind. Ndërsa në raport me muajin maj, janë ulur rreth 0.68 pikë përqindje. Me këtë trend në rënie për të tretin muaj radhazi, kreditë e këqija kanë shënuar nivelin më të ulët që prej vitit 2008 kur raporti i tyre arrinte në 6.5 për qind.

takuar shumë herë, Bacën Adem Demaçin asnjëherë! As në kohën kur ishte i sëmurë rëndë. Ramush Haradinaj e quajti gënjeshtar sikur që nuk mbeti kush nga Kosova, gazetarë, politikanë, artistë, këngëtarë pa u përqeshur dhe injoruar nga Goliati i Vuçiqit, Edi Rama. Edhe ata që e kanë përkrahur në fillim dhe unë kam qenë një nga ata, tash kanë ndërruar mendim sepse mendonim se Edi Rama është Piemont i bashkimit të shqiptarëve e po del të jetë anëtar i klubit kozmopolitan, që e shkel çdo vlerë kombëtare dhe njerëzore për ta shtyrë kozmopolitizmin përpara, si përcjellës i çetnikut Aleksandër Vuçiq. Realisht, kastat sunduese në Shqipëri, politikanët, akademikët, njerëzit e kulturës, shkrimtarët, gazetarët në të shumtën e rasteve i kanë konsideruar dhe trajtuar shqiptarët e Kosovës nga pozita raciste, ndërsa po kjo "elitë" është treguar inferiore ndaj Serbisë. Ekzemplari i fundit i këtij mendimi dhe qëndrimi racist është Edi Rama, para shqiptarëve të Kosovës dhe politikanëve të Kosovës, në tavolinë i nxjerrë koçet e elefantit, kurse para Aleksandër Vuçiqit dhe Serbisë këto koçe zvogëlohen me një progresion algjebrik duke u shndërruar në koçe të gjelit të tredhur. Merreni me mend, sot Shqipëria është i vetmi vend në Evropë ku shteti ka legalizuar trafikimin e qenieve njerëzore përmes agjencive të regjistruara që i shesin femrat e veriut të Shqipërisë dhe Shqipërisë së mesme, në Serbi dhe Maqedoni të Veriut. Shitja e femrave shqiptare bëhet në sy dhe prani të shtetit që udhëhiqet nga Edi Rama e që e kanë çmimin nga 3 000 deri në 5 000 euro. Dhe kujt ia shesin?! Ua shesin serbëve në Serbi që mund të kenë kryer krime ndaj shqiptarëve! Ka të tilla shitje të femrave shqiptare me qindra dhe kozmopolitanët nuk e çajnë lulin për këtë!

Kryekozmopolitani i Shqipërisë, së bashku me spermatozoidet kozmopolitanë në Shqipëri dhe mbetjet e Millosheviqit dhe të Vuçiqit në Kosovë, aspak nuk e kanë problem Kosovën dhe çështjen kombëtare e aq më pak Vuçiqin dhe Daçiqin, por luftën po e bëjnë kundër Albin Kurtit dhe nacionalistëve primitivë. Ndërkaq që nacionalistët primitivë e bën Shqipërinë, e bën Kosovën dhe pashmangshëm do ta bëjnë bashkimin kombëtar. Pa nacionalistë primitivë nuk do të ekzistojnë as trojet shqiptare, kurse mungesën e kozmopolitanëve të çiftit të Edi Ramës, Mustafa Nanos dhe adashëve të tyre në Kosovë do ta ndiejnë vetëm ata që paturpësinë e tyre përpiqen ta mbulojnë me një gjethe fiku!

**Albin Kurti, i Huaji për Ramën e jo për Albert Kamynë:** Duhesh të jesh së paku i marrë e të besosh se Albin Kurti është kundër interesave kombëtare dhe se do të marrë vendime kundër interesave kombëtare dhe shtetit. Dikush po përpiqet ta portretizojë sipërfaqësisht intelektualizmin e Albin Kurtit duke bërë krahasim me atë që e tha për vdekjen e nënës së Ramë Lahajt dhe fillimit të romanit të Albert Kamysë, "I Huaji". Kush e njeh Albin Kurtin e ka të qartë se ai ka qenë dhe është lexues pasionant i librave, i kupton ato dhe i përdorë edhe në terrenin politik. Këtë e ka bërë pjesë të retorikës të cilën e ka armë të kalibrit të rëndë me të cilët i mund të gjithë lojtarët dhe rezervistët e skenës politike të Kosovës. Thuaja është i vetmi nga Kosova që në lojën e shahut të retorikës është i barabartë me Edi Ramën dhe me Vuçiqin. Nuk e keni asnjë politikan që do ta përshkruajë me aq saktësi gjendjen në Kosovë. Në planin e veprimit nuk është autonom për marrjen e vendimeve. Prandaj, pas zgjedhjeve lokale, e që nëse nuk ndodh ndonjë e papritur, mund të fitojë deri në 15 komuna, vetë Albini do t'i provokojë zgjedhjet e përgjithshme për të siguruar një mandat të tretë. Kjo opozitë nuk ka asnjë kapacitet ta rrëzojë Albinin. Nëse ndërkombëtarët mendojnë ta gjejnë një alternativë kundër Albinit, zgjidhjen do ta kërkojnë te Vjosa Osmani. Albini po fiton kohë me bisedime deri të përfundojnë zgjedhjet lokale. Opozitë e Albin Kurtit janë Aleksandër Vuçiqi, plotësisht e kuptueshme dhe Edi Rama, plotësisht e pakuptueshme. Albin Kurti nuk do të lejojë që kjo qeveri ta çojë mandatin deri në fund sepse nuk i konvenon, as politikisht e së paku kombëtarisht. Albin Kurti duhet të përkrahet sidomos në bisedimet me Serbinë. Edi Rama duhet ta thërrasë mendjen dhe ta kuptojë se Goran Bregoviqi është pordhë e ftohtë për ta luftuar Albinin dhe nacionalizmin shqiptar. Aktualisht, Albin Kurtin mund ta rrëzojë vetëm Albin Kurti dhe proceset politike si bisedimet dhe marrëveshja përfundimtare me Serbinë.

Goran Bregoviqi, Mustafa Nano, Kulla dhe Mulla nuk janë incidente të çastit apo gjendje afektive. Janë pasojë e një vetëdijeje shumëvjeçare të deformuar dhe përpjekje që me procesin alkimik nga bajga të bëhet ari përmes heqjes dorë nga vetëdija kombëtare dhe transformimit në kozmopolitan transgjinor. Le të na lejojnë neve nacionalistëve primitivë ta jetojmë ëndrrën tonë. Mos të na imponojnë si standard njerëzor, moral, kombëtar dhe politik kozmopolitizmin që e mohon qenien dhe vetëdijen kombëtare. Edi Rama po manipulon me liberalizimin e vizave për Kosovën. Nuk është në pyetje mospërmbushja e kushteve për liberalizim. Liberalizimi është çështje e kushtëzuar për arritjen e një marrëveshjeje politike me Serbinë. Le ta nënshkruajnë marrëveshjen dhe do t'i kemi vizat... për Hajkobillë, Muçiverc dhe Muçibabë. Edi Rama është shndërruar në Brut, në Kain dhe në doktor Xhekil. Rast unik në botë, një i pafytyrë në të njëjtën kohë ka shumë fytyra. Po ne e duam Shqipërinë, e falim edhe Edi Ramën. E kemi falur edhe Ahmet Zogun dhe Enver Hoxhën.

**Një dritë e shpresës në fund të tunelit:** Se shqiptarët janë zemërmëdhenj dhe bujarë, jemi bindur gjatë historisë. Edhe në kohën kur udhëheqësit shqiptarë dhe udhëheqësit kozmopolitanë i kanë shpallur luftë njëri-tjetrit, ka të tillë që me sinqeritetin, konstruktivitetin, vullnetin, dashamirësinë dhe dashurinë kanë shfaqur gatishmërinë t'i pajtojnë shpirtrat e trazuar. Ky është Behgjet Pacolli të cilin e njohin jo vetëm në Kosovë, por anembanë globit. Si askush tjetër, Behgjet Pacolli i ka të gjitha vlerat më sublime njerëzore, politike, morale, kulturore e mos të flasim për vlerat kombëtare. Ma gjeni dikë që kombëtarisht është më në rregull se Behgjet Pacolli?!

# Interesimi për të investuar në bonot e diasporës ka arritur në 7 milionë euro

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 GUSHT - Qeveria e Kosovës ditë më parë ka filluar të ofrojë bono të Thesarit për diasporën me qëllim të orientimit të fondeve të diasporës në financime që mundësojnë zhvillimin ekonomik. E kur ka mbetur edhe një javë kohë për të investuar në këto bono, ministri i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije se interesimi për të investuar ka arritur në rreth 7 milionë euro. "Interesimi për të investuar në Bonot e Diasporës tashmë ka arritur në rreth 7 milionë euro. Megjithëse kemi ofruar dy afatizime, mërgata jonë duket se preferon investimin më afatgjatë në vend, sepse mbi 80 për qind e shumës së investuar është në Bonot pesëvjeçare. Mërgata për Kosovën", ka shkruar Murati.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe bankat komerciale partnere për lëshimin e bonove të Thesarit për diasporën.

Shuma totale e paraparë për këto bono është 20 milionë euro, me mundësi rritjeje deri në 50 për qind, nëse do të ketë kërkesa.

Për ata që blejnë bono të Thesarit me kohëzgjatje trevjeçare, interesin që do ta marrin do të jetë 1.2 për qind, kurse për paratë e investuara për pesë vjet, interesi do të jetë 2.2 për qind.

Kuponi i parë i interesit do të paguhet në muajin shkurt, kurse i dyti në gusht dhe kështu do të vazhdojë pagesa çdo gjashtë muaj, deri në përfundimin e marrëveshjes. Krejt në fund, kur përfundon koha e maturimit, personi që i ka lëshuar kredi shtetit, i merr të gjitha paratë e investuara.



# Ndahen 5 milionë euro për pagesën e polisës kufitare për mërgimtarët



Prishtinë, 11 gusht (ER) - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndarjen e 5 milionë eurove për mbulimin e pagesës së polisës kufitare për mërgimtarët. Me të gjitha votat për, u miratua propozimi i ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. "Përmes këtij propozimi Ministria e Financave ndan 5 milionë euro për mbulimin e pagesës së polisës së sigurimit për mërgimtarët që hyjnë në territorin e Kosovës", ka thënë Murati gjatë mbledhjes së qeverisë. Ai ka thënë se subvencionimi bëhet për të gjithë mërgimtarët dhe kanë vlerë një muaj.

# Vazhdojnë shtesat për pensionistët e familjet me asistencë sociale deri në fund të vitit

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të mërkurën mbledhje, ndërsa u vendos që të vazhdohet mbështetja me shtesa për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale deri në fund të vitit Hekuran Murati, ministër i Financave ka njoftuar se do të vazhdojë të vlejë pagesa shtesë prej 30-përqindësh mbi shumën mujore për përfituesit e skemës sociale dhe se do të vazhdojë shtesa për pensionistët që kanë marrë pension në vlera dyshifrore të mos marrin më pak se 100 euro në muaj. "Këtë e bëjmë me synim të krijimit të një shoqërie të barabartë. E konsiderojmë të veçantë ashtu që të paguhen shtesat për periudhën deri në fund të vitit 2021", ka thënë Murati. Në këtë mbledhje u vendos edhe për anëtarët e Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të ish-të dënuarve dhe të ndjekurve politikë.





# ‘Andrra e jetës’, një lexim i poemës së Ndre Mjedës

Sokol ZEKAJ

1
Mbi njëqind vjet më parë Ndre Mjedja shkruante poemën *Andrra e jetës*. Mendohet ta ketë filluar pasi është vendosur me punë në Kukël në vitin 1906. Atëherë qe dyzet vjeç, në lulëzim të aftësive të veta krijuese. Qe arsimuar e pajisur me dije të larta. Kishte jetuar në perëndim, dinte plot gjuhë të huaja, përfshirë edhe latinishten. Ishte autor i shumë lirikave e poemave të njohura me frymë romantike dhe atdhedashëse. Poema që përmendëm u botua për herë të parë në *Juvenilia*, në vitin 1917 në Vjenë.
*Andrra e jetës* është kryevepra e Mjedjes. Nuk kemi të dhëna për procesin krijues, por mund të besojmë se të shkruarit e saj ka qenë kënaqësi për autorin. Vetë ideja e poemës e ka gëzuar pasi tashmë, qe i mbushur nga jeta për të dhënë plot gjëra, të cilat ende nuk i dinte, por që i ndjente brenda vetes: shumëllojshmëri vargjesh e rimash, figurash e imazhesh, ndjenjash e përvojash. Vërtetë, poema do të kishte përsosmërinë e një vepre të madhe muzikore. Më duhet të them se, te *Juvenilia* më ka lindur ëndrra e jetës sime: ajo është vendlindja ime e poetit.

2
Mjedja është si ari: ai nuk u zhvlerësua në asnjë kohë, ndonëse kaloi nëpër hijedritë. Duhet ta besojmë se, sa ishte gjallë, siç na thonë bashëkohësit, qe i mënjanuar e i pavlerësuar sa e meritonte. Kjo ndodhte për shumë arsye të cilat janë thënë e shkruar, por edhe për faktin se poezia e tij ishte e rafinuar artistikisht, dhe donte një edukim estetik për ta shijuar, në një kohë kur në Shkodër shkruante Fishta, i aftë për të hyrë në rezonancë me dëshirat dhe shijet e lexuesve, madje duke bërë edhe edukimin estetik të tyre, siç bëjnë të gjithë poetët e suksesshëm.
Edhe Lasgushi bëri një poezi të ngritur nga ana cilësore. Veçoria është se, siç thotë me të drejtë Frida Idrizi, toni dhe ritmika e poezisë së tij ishin më pranë poezisë popullore, asaj të jugut, madje në më shumë se një rast, ai bëri inkursione poetike të vërteta drejt kësaj fushe. Këtë gjë, në mënyrën e vet, e pati bërë edhe Fishta në Veri. Mjedjes asnjëherë nuk i shkoi mendja për “lëshime” të tilla. Formimi dhe vetëdija e tij estetike ishin solide dhe gati hermetike ndaj tyre.
Nga ana tjetër, Lasgushi nuk krijoi dashakëqinj në jetë, ndërsa pati mbështetjen e vyer të Çabejt, të Kutelit e të Asdrenit. Kurse Mjedja, ndoshta edhe për sqimën artistike dhe intelektuale, më shumë ndjeu heshtje rreth vetes, dhe njerëz që e shihnin shtrembër. Por ai nuk ndryshon, don me qenë i vërtetë, thotë atë që ndjen, dhe sidomos nuk thotë të kundërtën e asaj. Ndoshta në vitet e fundit, qe edhe i lodhur nga jeta. Koliqi, një shkrimtar dhe poet bashkëkohës shkodran, na e paraqet “si një prift katundi ndër ma të lanunit…verë e dimën mbërthye në një pallto të randë të zezë”.
Por mund të thuhet edhe kjo: veshja e klerikut, nuk rri mirë në staturën e tij të poetit. Kjo gjë s’ka pse thuhet për Fishtën. Lasgushi nga ana tjetër, merrej si ishte, civil dhe modern, dhe kjo e ndihmonte. E njëjta gjë ndikoi më vonë në popullaritetin e Migjenit, me histori dashurie, me albume të fotografive, me plot kujtime shokësh e miqsh, e me përjetime e përkujdesje fisnike familjarësh. Ndërsa autori i Juvenilias nuk e pati këtë fat. Ai mund të jetë parë me dyshim, edhe nga besimtarët edhe nga jobesimtarët. Të parët e gjykojnë, të dytët e paragjykojnë.
Veç kësaj, te Mjedja jetojnë dy personalitete poetike: njëri i qetë dhe soditës, tjetri nevrik dhe stigmatizues. Unë për vete pëlqej të parin, padyshim. Por, disa gjëra nuk zhbëhen: realiteti dhe karakteri i tij, siç ndodh me të gjithë poetët e vërtetë në çdo kohë e në çdo vend, ishin dy ingranazhe që nuk përkonin. Sidoqoftë, qysh në fillim të viteve tridhjetë, ai u njoh si mjeshtër i madh, mes tjerëve edhe nga një poet i iluminuar si Lazër Shantoja, ndonëse me pak, me shumë pak zë!
Më tej, pas luftës së dytë botërore, ideologjia komuniste nuk gjeti dot arsye për të mos e çmuar e nderuar poetin Mjedja gjatë gjithë gjysëmshekullit. Koha e sotme është sot, në shekullin e ri. Në të vërtetë Mjedja është poeti që na ofron një vepër të begatuar me kuptimsinë e jetës, por duke trupzuar në vetvete elementët e artit elitar.

3
Mjedja bën pjesë te ata poetë, emri i të cilëve lidhet me vepra konkrete: ashtu si emri i De Radës lidhet me Milosaon, i Naimit me Lulet e verës, i Fishtës me Lahutën e Malcis, emri i Mjedjes lidhet me poemën Andrra e jetës. Fundja, emri i poetit jeton veçse përmes veprës së vet. Është vepra monumenti, nëse është. Tashmë kjo thuhet qysh prej Horacit.
Duhet patur në vëmendje se kjo poemë shënon realizimin kulmor, ku poeti do të investojë vetveten. Ndonëse poemë e gjatë, ajo e gjitha është brenda sensit të poezisë, dhe është gjithashtu shprehja më e qashtër, më e llagartë, e poezisë së pastër në letrat shqipe. Aty janë derdhur në mënyrë harmonike lënda, frymëzimi dhe mjeshtria e poetit. Është e vërtetë se pas kësaj poeme, Mjedja do të vazhdojë të gdhendë të tjerë vargje të bukur e me masë, por gjithsesi atyre do tu mungojë diçka nga ngjyrimi, nga esenca dhe nga thellësia e zërit të tij poetik.
Nga ana tjetër, a nuk gjendet mjeshtria e tingllimave Lissus e Scodra, te pjesa e dytë e *Zogës*, ku vargjet kaq shumë të përimtuar artistikisht, rrjedhin lirshëm, e ku metaforat flatruese e vezulluese, vallëzojnë përmes një gjuhe që na tingllon në shpirt? Ku tjetër në poezinë shqipe, mund të gjejmë kaq imazhe të paharrueshme, kaq shkathtësi të vargut e të ligjërimit, kaq befasi të bukura, dhe kaq elegancë të këndimit poetikë? Ndërsa e lexojmë, përfytyrimi ynë rrëshqet poemës si ngjala në rrymën e ujit të kthjellët. Ja, si këto vargje:

*Tue siellun krahnin këndote me vedi*
*E i rridhte krahve nji si val’ deti*
*Kur dielli shndritshëm lshote si*

→

*zhgjeta*
*Rrezet e veta*
*Rreze flak' arit…/*

Titulli i poemës, *Andrra e jetës,* është gjithashtu një metaforë që e kompleton veprën. Në fakt, kjo është si një kristal me shumë faqe, por më e para nga metaforat do mund të qe ajo që lidhet me Zogën, me ëndrrën e saj. Gjithsesi, nuk është vënë titulli kaq i bukur, si një trill, a si një artific. Për herë të parë në poezinë shqipe, një poemë, reflekton qysh në titull thellësi dhe kompleksitet. Ëndrra-jetë dhe jeta-ëndërr, janë metafora të lindura bashkë me njeriun mbi tokë. Përndritja e kuptimit të tyre e përshkon poemën nga kreu në fund: Trina dhe ëndrra e jetës, Zoga dhe ëndrra e jetës, Lokja dhe ëndrra e jetës. Ja, çfarë kemi në duar për të zbuluar! Dhe janë jo pak: poema ka 296 vargje.
Shumë prej këtyre vargjeve i di përmendësh. I kam lexuar qysh fëmijë, atëherë kur mësuesi im, Gjon Dionizi na thoshte se "*Mjedja ka ndenjë me limë në dorë mbi vargje*". Herë pas here i kthehem poemës për ta lexuar. Dua t'i shoh vargjet mbi letër, jo t'i kujtoj me mend.
Dua t'i shoh në letër edhe vargjet e pjesës së katërt të *Zogës*, për të cilat prej shumë vitesh bëj pyetjen: si e shkroi poeti këtë pjesë? Problemi është se kjo përbën një përjashtim krejt të papritur në arkitekturën e poemës, pasi befasitë poetike i ndeshim në hapësirat e brendshme, jo në fasada. Por vetëm kjo, pjesa e katërt, del nga logjika e ftohtë autoriale e kompozicionit.

4
Mjedja nuk shquhet për fuqi përshkrimi, Fishta po, gjithashtu edhe Lasgushi. Për këta të dy, kjo është një nga pikat e forta të artit të tyre. Prandaj Lasgushi është më pranë Fishtës sesa Mjedjes, si poet. Kjo është çështje e temperamentit të poetit. Në bisedë të lirë, thotë Koliqi, Mjedjes nuk i rridhte fjala. Mjedja bën dekor, vendos planet ku do të zhvillohet drama e jetës, dhe më pas punon me pak detaje, të imta dhe të zgjedhura. Atij nuk i intereson tërësia e një shfaqjeje, por pjesë të saj, të cilat i bashkon sipas synimit të efektit poetik, ja si këto vargje:

*E nalt n'qiell ma e bukur hana*
*Rreze t'paqta shkon tue shkri*
*Maje bjeshkve fillon zana*
*N'valle shoqeve me u pri.*

Ai synon të na krijojë një gjendje po aq sublime përmes mjeteve artistike, sa ç'është edhe ideja e dashurisë të cilën e mbart kjo pjesë e poemës. Këtu, te ky projeksion i intelektit, mund ta kenë origjinën rezervat që janë shprehur ndaj artit të Mjedjes, sipas të cilave, poeziae tij "*buron më shumë nga mendja se nga zemra*". Por kjo mund të mos jetë e mirëmenduar, pasi vetë përsosmëria e gjërave ka një natyrë saktësimi dhe përpikmërie, gjendje që mund të arrihet veçse në një ndërkallje të vetëdijes dhe pavetëdijes, frymëzimit dhe intelektit.

5
Poema është e ndarë qartë në tri kohë. Mes kohës *Trina* dhe asaj *Zoga* rri pa u ndriçuar afërsisht një dhjetëvjeçar, dhe po kaq edhe mes *Zogës* dhe *Lokes*. Por koha brenda secilës kohë është e shkurtër, dhe kjo e ka bërë intensive poemën. Mjeshtri Mjedja nuk e mbush veprën as me vargje përshkruese, as me ide të thata. Poema kumbon nga gjërat e qashtra e të përjetshme. Kemi pra një familje fshatare, nënën me dy vajza. Nuk ka dyshim se shmangëja e burrit në poemë nga autori, është në funksion të synimit estetik të saj. Por, të mos largohemi nga mendimi, njëra vajzë vdes, Trina. Tjetra, Zoga, vjen dita dhe martohet. Mbetet Lokja e vetme, e cila në një natë të egër dimri, vdes.
*Trina* vjen si një poemë dramatike. Ritmet kapriciozë të shtatërrokshave të këngës së dytë, që japin kthimin e Trinës në shtëpi, na kujtojnë ritmet e lojrave të fëmijëve në oborr. Trina dhe Zoga janë fëmijë. Lokja është grua e zoja, e fortë, aq e fortë është, sa merr viçin dhe e çon *rrshanë te murgjina*. Murgjina, është emër përkëdhelës dhe mujçitës i lopës, dhe do thoshim se vjen nga fjala murgë. Kjo pjesë na tregon se sa e vërtetë është ndjesia e realitetit te Mjedja, i cili nuk e ngre ngrehinën e vet të artit, poemën, me themele në erë, as me fjalë herbariumesh. Përkundrazi, ndjesia e tij e realitetit është vitale, dhe ka dimensione të gjëra e të thella.
Poeti ka zgjedhur të mos na e japë direkt Trinën. Vetë ai na lajmëron në këngën e parë, se do të vijë në mbramje me një qingj të sapolindur. Është e trishtueshme vetëdija e detyrës për të jetuar, tek fëmija, e që prap nuk jeton. Pse poeti i caktoi Trinës këtë fatë Se kësisoj ishte jeta, e mbase është edhe sot, me ngjyra të forta të cilat rrinë ngjitur njëra me tjetrën. Në veprën e Mjedjes nuk ka asgjë artificiale, gjithçka buron nga e vërteta dhe mbërrin te e vërteta, larg lojrave pa kuptim. Po, ç'gjuhë e bukur, ç'muzikalitet i vargut:

*Moli tue këndue lopën*
*Tue pritun viçin prorë*
*E tambli bardh si borë*
*Përmbrenda mjelces ngufoj.*

Ja edhe dy vargje që na e vënë në lëvizje imagjinatën: *E Shega e lehtë si kashtë/ Tue kcyemun u bërlyk.* Kashta e lehtë dhe viçi (ka emrin *Shega* prejse është me ngjyrë të kuqe dhe që duhet të jetë femër, prejse ka emrin femror), bëjnë një metaforë vizuale origjinale dhe moderne. Të përfytyrojmë një kashtë që e merr era nëpër oborr: ajo është e hollë, e lehtë dhe ndërron trajtë, mblidhet, hapet, krijon figura të papritura, ndërsa lëviz andej-këndej, duke u ulur e duke u ngritur mbi tokë. Ja, kështu lëviz edhe *Shega q*ë sapo ka dalë nga *burgu* ku ka qenë i ndrymë.
Ndërsa parandjenja e vdekjes dhe ajo çka Lokes i fanitet buzë votrës, janë imazhe të paharrueshme. Është natë. Në mes të errësirës, flaka e një pishe. Kur ke njeri të sëmurë, nata bëhet e pafund. Nëna tjerr penj për të ardhmen ndërsa fytyra i është *vrâ* (në kuptmin *i vranët*, kohë *e vranët*) e sytë i mbushen me lotë. Për ta shprehur poetikisht gjithë këtë tension psikologjik e shpirtror, poeti ka zgjedhur një frazë poetike që zhvillohet në tetë vargje të dendësuar e të ngarkuar me imazhe e me emocion. Ja çka i fanitet nënës së lodhur nga pagjumsia dhe frika e së keqes:

*E tirrte prep te votra*
*Penj tirrte per xhubleta*
*E i dukej se tu këneta*
*Se n'shpella me drangonj,*
*Tirrshin dhe shtojzovallet*
*Tue luejtë pa mejun gishtat.*
*Siellshin me pleq ferishtat*
*Ndoshta dhe fëmin' e vet.*
*E shkoi me i pa tuj pritun*
*Dritën e pishës me dorë.*

Ky udhëtim shpirtror i Lokes nëpër errësirë, me dritën e pishës në dorë, me imazhin e shtojzovalleve te këneta në mendje, që *luejnë pa mejun gishtat*, ky udhëtim pra, nga votra ku po tjerrte me sytë e mbushun me lotë, deri te të *shtruemet* e fëmijve, është i gjatë i pafund. Imazhe mbas imazhesh na përshkohen nëpër mend, si një film. Por, kjo këngë ka edhe një befasi të cilën do ta shohim më pas.
Gjithashtu te Trina kemi figura të tjera letrare si kjo: *Paq i kthelltë prej Perendije*,/ Ky epitet origjinal me shkëlqim dantesk i një *paqeje të kthjelltë*, sa vizual aq edhe konceptual, për nga bukuria dhe funksioni estetik, rri si një nga gurët më të çmuar në poemë, të cilët në të vërtetë nuk janë të rrallë. Dihet se konceptet janë produkt i intelektit, i *mendjes*. Kjo nuk don të thotë se kemi një poet të pandjeshëm ndaj natyrës, përkundrazi lidhja e Mjedjes me natyrën, më parë se të jetë poetike është shpirtrore dhe intime. Të tillë e shohim te poezitë për stinët, apo te poezia *Vjollcës*, por edhe te kjo, poema *Andrra e jetës*, sidoqoftë, duke mos dashur asgjë false, as optimizmin.

Këto nuk janë sajesa mistike por mjete artistike për të dhënë botën shpirtrore të personazhit, të cilin e ndjejmë poetikisht të afërt, si njëri prej nesh. Ajo që marrim nga këto imazhe, është ndjenja se vdekja është një e keqe e vështirë, dhe se ajo duhet refuzuar. Në poemë Mjedja ka vënë ato që beson si poet, ndërsa ato që beson si klerik a si dijetar a si patriot, i ka lënë tash për tash, në bllokun e shënimeve. Duhet shënuar se kjo është koha kur në Shkodër kishte marrë goxha vrull arti: në letërsi me Fishtën, në pikturë me Idromenon, në fotografi me Marubin, në muzikë me Palokë Kurtin.
Pra, Trina, vajza e njomë shuhet. Në këto kushte, Lokja, "*me zemër t'plasun*", ndjen më shumë dhimbje, ndoshta edhe faj, madje edhe ndjesi dënimi nga fati, por ka edhe detyrën e vështirë me qenë e fortë, sepse mban shtëpinë të ngritur, dhe për sa kohë je në pemën e jetës, duhet mbajtur aty me thonj. Por ka edhe një gjë: duhet dhënë shëmbull force, jo dobësie, për të bijën. Kjo është një filozofi e konsoliduar fort, e popullit.
Kënga e dytë e Trinës, është modeli se si gjërat reale të drejtpërdrejta, të cilat nganjëherë vijnë më të çmuara se të imagjinuarat, rrinë brenda nesh përbri me përjetimet fantazmagorike. Këto në fakt na zgjohen rrallë, atëher kur jeta jonë vihet në zgrip. Dhe, të kujtojmë vargjet:

6
Pjesa e dytë, *Zoga*, është një hymn për moshën e rinisë e për vijimsinë e jetës. Vargjet dridhen e vezullojnë nga pasioni i bukur i dashurisë. Por e gjithë poema zhvillohet përmes antitezave dhe analogjive. Antitezat janë: pranvera- dimri, jeta- vdekja. Ndërsa analogjitë janë të shumta. Por analogjia, krahasimi dhe metafora vijnë nga e njëjta natyrë e gjërave, dhe këto janë të shumta. Zoga fillon pikërisht me këtë buisje pranverore. Madje përveç bylbylave që këndojnë në ograja:

*Drandofilleve zymbylat*
*T'kandshmen erë dhunti iu çojnë.*

Paralajmërohet një martesë. Poeti ka hyrë me dëshirë të madhe në botën shpirtrore të heroinës së vet, Zogës së rritur tashmë. Shkëndia e zjarrit shndrit fytyrën e saj dhe ajo duket si engjëll ndërsa fle, që do të thotë, duket e qetë e pastër, e pafaj. Por shpirti njerëzor zbulohet duke hyrë aty. Metafora e këtij penetrimi jepet në dy vargjet e para të këngës së dytë, si një rreze dielli që ka hyrë brenda shtëpisë nga një tjegull e thyer:

*Prej nën nji tjegllet kish dalë si j'tra*
*ku njimij' tesha vloshin pa da,*

Këto "njëmijë tesha" janë pikërisht mjëmijë gjërat që vëlojnë në shpirtin e Zogës. Deri, edhe rruga e vjetër, ndërsa Zoga sheh nga dritarja, *nën shpi, mbas gardhit diçka si dritë / Shkote tue qitë.* Bota shpirtrore e Zogës është në lëvizje e në zbukurim, gjëra edhe këto që kanë peshën e tyre pasi, frekuenca e lartë shpirtrore është e vështirë, prandaj:

*U nis te puna mërzitshëm. Nisi*
*Ndër penj sovajkën e shpata krisi*
*Cirlikne rrotllat posht' e përpjetë*
*Nën kambë të shpejtë.*

Por: *Duel n'dritare prap. Ndoshta begu / Ka mbërri…/* Analogjia e krijimit të familjes vijon me dallëndyshe e me bylbyla. Natyra nga ana e saj është e plotë. *Vijn' dallndyshet porsi era.* Edhe ujët që vjen fushave për të rritur bimë e lule, nuk është dosido por i kulluet, ujë bore: *lehtas prroni malit ulet / da prej borës që i nep ushqim.*/ Ky ujë do të përtërijë jetën:

*E i dishruem bje për fushore*
*Me rrit' bimën për gjith vend*
*Ku j' erë akullit mizore*
*Kishte hupë lulzim e shend.*

Ja një antitezë ku ritmi dhe rimat, bashkë me epitetin *mizore* që cilëson në përmbajtje *erën e akullit*, vijnë po aq të përkryera sa gjuha poetike dhe sa kthjelltësia e ideve. Dhe këtu, te kjo këngë, poeti gjen rastin të bëjë një ndërhyrje të drejpërdrejtë, e t'i thotë Zogës se, si ky përrua që ndahet nga bora, edhe ajo duhet të ndahet nga shtëpia ku ka lindur, dhe ashtu e pastër të rrisë jetën diku tjetër.
Por, pse të mos e themi se djali i ëndrrës së një vajze sot ka ndryshuar, ndonëse më shumë si fjalor dhe rekuizitë se si imazh. Kështu nuk quhet *beg*, një fjalë me konotacion disi arkaik, madje nuk po quhet as *princ*, nuk vjen mbi kalë me kobure e gjëra të tilla që na kujtojnë letërsinë *kalorsiake*. Por, cila poemë e madhe nuk mori pak ndryshk nga kohaë
Mirëpo më duhet të flas edhe për një metaforë të cilën për besë, them se nuk duhet të kalojë nxënës shkolle pa e ditur. Janë vargjet:

*Fjet bri votrës: e kur shkndija*
*Shndritte at' fëtyr' të patravaj*
*Ejll prej qiellet ulë te shpija*
*Dukej faret fëtyra e saj.*

Në fakt, ngjashmëria e vajzës me një engjëll në një poemë, gjithsesi nuk përbën ndonjë befasi të madhe, por të tillë e bëjnë rrethanat. Është fillim pranvere, por ende bën ftohtë. Vajza është shtrirë, dhe pasi ka shkëmbyer ndonjë (jo shumë) fjalë me nënën e vet, *fjet bri votrës*. Është kjo *votër* ku ka lindur e është rritur, e për të cilën do të ketë mall gjithë jetën. Kjo i kujton edhe motrën, Trinën të cilën tash s'e ka. Errësira e natës ka mbushur shtëpinë, por zjarri

digjet në votër me dru *dullinjet* (jo lisi të fortë) të cilat i ka bërë Zoga *në mal pa motër*. Ndonjëherë, kur zjarri bën shkëndija, kur shkëndijat krijojnë kunorë drite në mes të errësirës, në atë çast të shkurtër, sa zgjat blici i një fotoaparati, por pa dyshim shumë herë më të bukur, në atë çast, si kujtesë e papritur në mes të harresës, vajza e fjetur duket si *ejll ul' prej qiellet*. Po, a është Zoga *e patravaj* siç na e thotë epiteti në vargun e dytëë Po, është, sepse ajo si personazh, nuk është e ngarkuar me shumë simbolika, ajo nuk është ndonjë Antigonë as motër e Gjergj Elez Aisë, nuk ka ndër mend *me përtëri* themelet e shtëpisë së vjetër! Vetë fjala zbërthehet: *me t'ra vaj*. Ndërsa gjithë shqetësimi, gjithë ëndrra e Zogës është *me ba jetën e saj*, pra me dalë nga shtëpia si një engjëll, prejse ajo nuk është veçse një vajzë e zakonshme, por e përjetshme. Po, kujt i hyn në punë poezia, nëse nuk pasqyron në esencë jetën njerëzore dhe shpirtin njerëzor!ë

7

Ndërsa *Lokja*, shpreh epilogun e një jete. Është një epilog i vështirë por ne jemi gati ta lexojmë e të marrim emocione, pasi këto janë gjëra të përjetshme, dhe janë dhënë nga autori, me një fuqi artistike do të thoshim, ekuivalente me idenë.

Kënga e parë karakterizohet nga toni i ulët dhe i qetë në dukje, por në fakt e gjitha është si një figurë e vetme, jeta në gjendjen e cakut të mbramë, por kjo e stolisur me diamante artistikë. Nëpër të gjashtë strofat e saj shkëlqejnë idiomat si shprehje metaforike me vlerë të përjetshme ku sintetizohen vlera morale dhe estetike. Të tilla janë: *Vetun zbardh e vetun erret / Me krye n'hi e shuemja plakë* / Apo: *Sot e reja i kishte dalë / Bashkë me dritë për dru në shpat.* / Apo: *Edhe lokja me gjith' tjera / Kishte dal' me petka n'shtat.*/

Ndërsa në këngën e dytë, toni ngrihet: të gjithë instrumentet e orkestrës tingëllojnë fort:

*U shty vjeshta e krisantemi*
*Vetun vorreve lulzon*
*Land'e pyje gjith' ku kemi*
*Tuj fry veri po i cungon.*

Ja edhe ironia e fatit të dikujt:

*Ndrron prej dimnit landa veshën*
*E lshon gjetht që para pat*
*E për mshirë duhit' që ndeshen*
*Ia çojn' t'vorfnit me i ba shtrat*

Pra, rasti i Lokes nuk është as i vetmi as më i padëshiruari. Ndoshta askund në poemë nuk është kaq e qartë nota kritike. Papritur, këndi i shikimit bie mbi plagën shoqrore të vorfnisë e mjerimit me një dritë të fortë, dhe ne ndjejmë një si rribë ere që na bën të dridhemi. Janë duhitë që ndeshen mes tyre për interesat e



dikujt, ndërsa njerëzit e thjeshtë bëjnë theror jetën e vet.

Po, dimri është i egër, me borë e orteqe që ushtojnë. Lokja *rri me duer kah ndezet flaka / porsi nieri kur uron.*/ Imazhi i Lokes *me duer kah flaka* nuk ka qenë i vështirë për tu imagjinuar nga poeti. Detaje të tilla ka plot në poemë. Këta janë marrë direkt nga jeta reale por kanë një forcë të madhe emocionale, pasi e tillë është ngarkesa e tyre edhe në jetën reale, plot trazime ekzistenciale. Duart e Lokes janë të drejtuara kah flaka për të marrë sa më shumë ngrohtësi prej saj, pasi asaj i beson më shumë këtë natë, flakës. Megjithatë, e sheh faktin para të cilit ka mbërritur. Ajo që vë re tash, këtë ças, është pasqyra e jetës së vet, "*një dritë e venitun*", jo më një dritë e fortë ku shquhej forca dhe përpjekja. Në fakt ëndrra e jetës së saj nuk është realizuar si ka dashur. Le të themi se ajo, ëndrra, bashkë me forcën dhe vullnetin për jetën, kanë kaluar tek e bija, Zoga, pasi ëndrrat njerëzore janë të ngjashme, nuk janë të pafundme, gjithsesi.

8

Duhet të themi, se nuk kemi të bëjmë me vetsakrifikim të Lokes, si është thënë në ndonjë rast, apo me shprehje misticizmi, si është thënë në ndonjë rast tjetër. Keqkuptimi mund të ketë nisur me vargjet:

*E larg morden tuj kositun*
*E kujton e pran' e thrret.*

Por, kjo morde që kosit, është metafora konceptuale e vdekjes, nuk është ndonjë qenie që ka marrë kosën në dorë dhe i bie botës, ndonëse kjo mund të ketë një zanafillë biblike të lidhur me epidemi mortaje. Këtë metaforë autori e përdorë edhe te Zoga, në këngën e tretë në strofën që bën fjalë për mbretin David: *Kur sheh morden se kositi / Anpëranë krajlnin e vet.*/ Mbreti David u ndëshkua nga Perëndia me epidemi mortaje për mëkatin që pat bërë. Sot ne kuptojmë, se sa pa integritet konsiderohej qenia njerëzore sipas vizionit biblik. Sidoqoftë shtrati realist dhe human i poemës, nuk na krijon asnjë shteg për ta transpozuar imagjinatën tonë në koncepte as imazhe të tilla.

Por, kur të mbarojnë fuqitë, kur e ndjen se po të shuhet flaka brenda vetes, njeriu ndoshta e kupton fundin. Lokja këtë bën, "*e kujton morden*", nuk tmerrohet nga ndonjë imazh i zi, por e pranon faktin, gjë që do të thotë se është me mendje të kthjellët deri në fund. Në këtë moment, nëse do të kishte njerëz pranë, ajo do të kërkonte *hallall,* falje. Mungesa e tyre, është dhimbja e fundit, por edhe shprehja ekstreme e qëndresës. Për njerëz me fuqi të tillë jetësore, flitet me respekt dhe thuhet"*vdiq me mend e me gojë*". Kjo është Lokja. Te vargjet: "*U ndie j' frymë përmbrenda shpijet / porsi erë që vjen pa shkas"* kemi një metaforë të pashoqe të vdekjes. Po, si vjen era kur nuk ka një shkas për t'ardhunë Ajo qe një "frymë", një erë që asgjë nuk e nis, nuk ka burim askund, por vjen, ndonëse nuk fryn. Në të vërtetë, veçse u ndje kështu prej Lokes, si frymë a si erë, por ajo ndjehet, jo nga lëvizja pasi nuk ka një shkas për këtë, por nga prania, sikur ajo qenkesh kudo, edhe brenda jetës së pafundme. "*Dekën e kem' ma pranë se këmishën e shtatit*" thotë populli, ndërsa thotë edhe shprehjen tjetër më të çuditëshme: *ne të gjithë jem' të bijtë e dekës*. Vargu i fundit është: *U ndal drita e ajo mbaroi.*/ Dhe, perdja bie. Në të vërtetë krejt poema përshkohet nga drita. Më bëhet se është esenciale të perifrazojmë vetë Mjedjen nga një poezi tjetër e tij, dhe të themi se krejt poema është stolisur me dashtni dhe shije, me dashurinë për jetën e njeriun, dhe me shijen e hollë për të mirën e të bukurën. Kjo është *Andrra e jetës,* një vepër kuptimesh të kthjellta, kurrë të vjetruara.

9

Por duhet thënë edhe një gjë jo pa rëndësi. Në epilogun e jetës së vet Lokja nuk e kujton asnjëherë të bijën, Zogën, ndërsa kujton Trinën me dhimbje, dhe kujton gjithashtu me dhimbje *se nuk bani kurrnji djalë*. Ajo ka dashur të ketë një djalë, më pas djalin ta martonte, dhe kjo të ndjente dashurinë e fëmijve të tij. Ja, kjo ka qenë *andrra* e Lokes, e cila nuk u realizua, ndonëse qe një ëndërr realiste, nuk qe për t'mos u ëndërruar, dhe as nuk qe pa kuptim. Ndërsa për Zogën, pra, kemi heshtje. Asnjë varg, asnjë fjalë për fëmijën e vet të vetëm në jetë. Harresëë Përseë E vërteta duhet të jetë se Lokja e ka kujtuar, domosdo, por poeti nuk na e thotë. Ka një arsye, sigurisht. Arsyeja është se nëse ai, poeti, do të fliste për të, fjalët e tij do të ishin qortim për bijën që e ka lënë nënën në këto kushte. Prandaj ai ka hedhur mbi të heshtjen. Kjo heshtje e nënës në ditët e fundit, në çastet e fundit, është qortimi, kritika. Por, ka një problem: te *Zoga* vetë autori e ka miratuar ndarjen e bijës nga nëna, *si prroni që ndahet nga bora*. Me sa duket qëndrojnë të dyja: edhe miratimi edhe qortimi. Ja pra se jeta ka nyje që nuk zgjidhen dot. Nyjet e pazgjidhura e shoqërojnë njeriun në jetë, dhe kjo përbën dramën e tij. Kështu, poezia e Mjedjes nuk është mashtruese si vera e ëmbël. A mos vetë poeti ka ndjerë një brejtje ndërgjegjeje ndaj nënës së vetë Lidhur me të, te poema *I tretuni*, ka shkruar: *E kurrgja n'ankime t'tija / Përpos' nanës s'i kam ndi.*/ si edhe: *N'kohë ma t'mir' për ty un treta / Kur pleqnija kërkon paq.*/ Njësoj si personazhi i vet i poemës, Zoga!

10

Detajet shpesh marrin vlerë simbolike si "*shllunga e rrasun*" e leshit që Lokja tjerr është vetë jeta e saj, "*era e akullit mizore*" është fati i keq që i mori vajzën, Trinën, "*nji prrue që prej malit ulet*" është rinia e Zogës që do të përtërijë jetën etj. Po, sa e hidhët është ndonjëherë ironia e jetës! Kur vajza është në vlimet e ëndrrës së vet të moshës, poeti vë në gojën e Lokes këto fjalë që burojnë thellësisht nga të qenët e vet, por që janë në disonancë me të vërtetën e jetës: *E nanbardha tue shikjue: / Flej me engjëj thot', o bijë / pusho shtatin me i ndihmue / lokes sate nëpër shpi*. Por Mjedja është realist, nuk i hedh asnjë zbukurim këtij raporti nënë-bijë për të ëmbëlsuar gjoja, kuptimin e gjërave. Jo, ai nxjerr në dukje anën dramatike të Lokes si personazh. Kjo është jeta. Por nuk e di a e vutë re, në vargun e parë fjalën *nanbardha*: është e krijuar nga emri *nanë* dhe epiteti *e bardhë,* e mbështetur estetikisht nga tingulli *a*, një fjalë që ka vlerën e një metafore, si një nënë që e ndjen për detyrë të ndihet gjithsesi *fatbardhë*, pasi ka një vajzë, fati i së cilës është fort i rëndësishëm. Në fakt, në më shumë se një rast, e ndjejmë autorin të bëhet personazh aktiv në poemë, duke promovuar një qëndrim kuptimor apo emocional.

Poema pra është realiste, një ansambël notash shumë të ndritshme dhe shumë të errëta, shumë të ëmbëla dhe shumë të hidhta, shumë serioze dhe shumë ironike, të gjitha të dhëna jo përmes ilustrimesh fotografike të romantizmit, por përmes gjendjesh shpirtrore, analizash psikologjike dhe lëvizjesh intensive të vëzhgimit e të imagjinatës.

Si çdo vepër e vërtetë arti, poema reflekton më shumë se çka thotë. Ne e kuptojmë gjendjen e prapambetur e të varfër të fshatit, ndërsa ndjejmë vdekjen e Trinës, por detajet që na sjell autori, thonë se familja ka në tryezë: *Pshesha me kollomoqe / t'mir' edhe për zotni.* Pra në pasqyrimin e jetës, poeti është i përkorë, dhe *këtu dhe tani* ai po synon harmoninë dhe arsyen, dhe jo ndonjëfarë "realizmi kritik". Në shënimet estetike, Mjedja tregon klasin e tij të lartë kur shprehet: "*poeti ka për qëllim me shëmbëllye bukurinë"*. Madje edhe vendi ku zhvillohet poema, i tillë është zgjedhur, plot harmoni: *Paq i kthielltë prej Perendijet / Paq prej nierit e qeti.*/ Duhet të vëmë në dukje këtu se gjeografikisht vendi nuk identifikohet por poeti thotë: *ku fillojnë kufijt e Geget*/. Duke marrë në konsideratë natyrën që na jepet në poemë, kuptojmë se, siç bën Fishta me "*Lahutën…*" edhe Mjedja zgjedh diku kufijt veriorë të "*Geget*", atje ku ka bjeshkë, borë të mëdha, orteqe, gurra që ushtojnë, por edhe zana të hijshme e të bukura. Dhe, meqenëse Mjedja bën dekor funksional, ka edhe fusha të begata. Pra *fillimi i Geget*, nuk duhet kërkuar në jug as në qendër siç është supozuar ndonjëherë pa

kuptim, por në veri, diku ndër ato vende ku "*ndër djepa rrisin/ nanat e Hotit djelmenin' ushtore*".

11
Dhe, më duhet të them edhe një gjë që është esenciale për poetin tonë: poema është një visar ku shkëlqen gjuha kumbuese dhe idiomat elegante të dialektit verior të shqipes. Vërtetë, te Fishta gjuha paraqitet më e pasur për arsye të lëndës që vepra e tij ngërthen, por te *Andrra e jetës* ajo vjen më e zgjedhur, më e kujdesur, më e gatshme për tu çmuar.
Mjedja ka ardhur te ne si poeti i frymëzimit të përmbajtur dhe i punës këmbëngulëse, veçori këto të pasqyryuara te kjo poemë. Ja, po vë në dukje një simetri të habitshme të rimave të cilën e pata paralajmruar! Te *Trina*, në këngën e dytë e të tretë të saj, kemi një skemë rimash komplekse që kryqzohen e alternohen në tetë vargje: ABBC-ADDC. Në fakt për vargjet e para, kemi asonanca ose konsonanca, duke bërë që fraza poetike të jetë më pak e kufizuar, më e lirë në lëvizje. Tani, të njëjtën skemë të rimave, autori përdor edhe në këngën e parë te *Lokja*, që është e parafundit e poemës e që fillon me vargun: *E n'balkue mbaruene lulet/* A mos është një rastësi kjo vendosje simetrikeë Them se jo. Mjeshtri Mjedja synon ta ngarkojë artistikisht krejt masën e veprës, përmes kumbimit harmonik të mjeteve që ka në dorë, deri edhe përmes simetrisë së tyre. Ja pse poema tingllon për ne si një vepër e madhe muzikore!

12
Thashë që pjesa e katërt e Zogës, është një përjashtim befasues. Nuk kemi zhvillimin e pritur të gjërave si mund të qe, krijimi i familjes së re. Me sa duket, poeti nuk ka dëshirë të krijojë një dekor të ri për vendin ku Zoga është martuar, dhe as të shtojë një lëndë të re që do ta vështirësonte funksionin estetik të poemës. Si thamë, burrat "i ka flakur" nga poema. Përse vallë? Mjedja e humbi shpejt babain dhe u rrit nën kujdesin e nënës, dhimbja për të cilën nuk iu shua kurrë. Ai kujdeset për ta shmangur sa të jetë e mundur epizmin që në esencë nuk i përket poezisë, duke këmbëngulur në tonin lirik dhe dramatik të poemës. Madje, edhe dy fëmijtë e Lokes janë dy vajza, asnjëri nuk është djalë.

*Molla t'kputuna nji deget*
*Dy qershia lidh' n'nj rrfanë*
*Ku fillojnë kufijt e Geget*
*Rrijnë dy çika me nji nanë.*

Ato janë "dy mollë" a "dy qershia", nga frutat më të bukur që rrit toka, plot ngjyra dhe shije.
Kjo metaforë kaq e gjetur, kaq subtile me të cilën fillon poema, na krijon ne një sugjestion befasues, dhe na vendos në një marrdhënie të pafund besimi me lëndën e poemës, duke e ndjerë se ajo do të jetë e pasur dhe e vërtetë. Vetë poeti ka në dorë tashmë një lëndë të çmuar, të përshtatshme për realizimin e synimit të vet artistik: bërjen bashkë të zërave poetikë që ndjen brenda vetes, në një vepër të bukur, të thellë, realiste dhe harmonike. Si në një piramidë të ngritur me shufra diamanti, ata zëra mbajnë dhe mbështesin njëri-tjetrin.
Siç është kredoja e poetit, krejt poema përshkohet nga ndjenja e së bukurës, e së lartës dhe e fisnikes. Edhe bylbylat këndojnë *valle darsmet e fisnike"*. Idetë janë të thella por edhje të kthjellta dhe nuk hyjnë nëpër labirinte. Lëndës së poemës i jep formë një imagjinatë e pasur e cila prodhon pa pushim figura letrare, të perceptueshme përmes shqisave apo koncepteve.

13
Kënga që fillon me vargun e paharrueshëm për kumbimin shqip: *E kandshme asht hana*, e cila në mënyrë të pabesueshme me sa di, nuk është vënë në muzikë nga asnjë kompozitor, gjë që tregon për lidhjet problematike mes arteve në Shqipëri, pra kjo këngë, ka njëzetekatër vargje të kombinuar, pesërrokësh dhe shtatërrokësh. Ritmi kërcen si gishtat mbi tastjerë. Rimat janë sipas skemës AABCCB. E gjithë pjesa zhvillohet në kërkim të një metafore, të kërkuarit e së cilës na çon në një varg analogjishë sugjestionuese për buzëqeshjen e foshnjës, *kur nana mbi të përkulet*/.
Poeti ndodhet në një gjendje kërkimi dhe meditimi. Pothuaj është shkëputur nga realiteti dhe është sublimuar për t'iu kthyer këtij realiteti me një dhuratë superiore. Gjithçka që ka të bukur toka jonë, i vijnë nëpër mend. Problemi është se duhet të zgjedhë, dhe jo vetëm kaq, duhet edhe t'i shprehë me gjuhën e harmonisë, pasi zgjedhja e idesë dhe ajo e përkujdesjes poetike, duhet t'i përkasin të njëjtës shtresë të lartë të origjinës. Ndërsa lexojmë vargjet:

*E kandshme asht hana*
*kur del me zana*
*e n'tokë me dritë përndaret*/

pra, kur lexojmë këto vargje, ne nuk na vjen ndërmend ndonjë gjë mitologjike a mistike, por imagjinata jonë vihet në punë për të kujtuar bukuritë e pashprehshme, ndonëse tokësore, me të cilat ne çojmë jetën tonë, por për të cilat jo aq shpesh kujtohemi. Më tej:

*Kur del agimi*
*e rruzullimi*
*me j'drit' kuqloshe mbëlohet*

shkruan autori. Ne ndihemi të rrethuar nga drita e agimit. A nuk kemi këtu një perceptim të çuditshëm impresionistë Ndërsa era e lehtë, flladi, na vjen si një vashë:

*E k'naqshme ajo lule*
*kur iu përkule*
*o fllad i lehtë me e lmue.*

Dhe, vërtetë, sa e kënaqur, duhet të jetë ajo lule nën përkëdheljen e flladit, që vetë ndërkaq *me erna veshet,* si një vashë, me ernat e lules! Pra, poeti u referohet bukurive të qiellit të natës, të dritës së agimit dhe të ditës së pranverës. Por më bëhet se, të shkruarit e kësaj kënge nuk ka filluar me asnjërën nga këto, por me vargjet e fundit: *foshnjës që i qeshet / nanës, kur mbi të përkulet.* Madje, edhe ideja e vetë poemës ka ardhur mbasi është shkruar kjo këngë. Dhe, ka ardhur pikërisht për ta mbështjellë këtë margaritar, për t'i krijuar idesë metafizike të vijimit të jetës njerëzore, një botë ngjyrash të vërteta jete dhe arti. *Eureka*! po krijohej mundsia për të bërë diçka që s'e ka bërë, për të shprehur ato që ka akumuluar si poet, në gjithë këto vite leximi, vëzhgimi dhe kërkimi, duke shmangur shkumën dhe mbetjet, dhe duke lënë veç *lëndën e kulluet* që rezulton në fund të rafinimit, ku përftohet poezia e pastër! Një energji krijuese e vërtetë qe vënë në lëvizje, dhe po rrihte muret e ndjeshmërisë, të intelektit e të imagjinatës.

14
Këto i kam menduar prej shumë vitesh. Por nuk kam as fakte as argumenta, përveç diçkaje shumë subjektive të përjetuar në jetën time. Ka qenë viti 1972, qershor. Pak kohë më parë kisha filluar punë si agronom në Koplik. Atë ditë, ndërsa po dilja nga qyteza për në fusha, më ra udha të kaloj pranë çerdhes së fëmijëve. Siç ndodhin në jetë gjëra të rastit që befas bëhen të rëndësishme, ktheva kokën nga porta e madhe e hapur, dhe më mbetën sytë te një gjë shumë e zakonshme, por edhe e pazakonshme atë çast për mua: një nënë po i jepte gji foshnjës së vet, në dritën e kaltër të asaj paradite vere. E njihja: ishte një grua e bashme dhe e hijshme. Gjiri i saj i zbuluar ishte i plotë dhe i trëndafiltë, ndërsa nën të një foshnje, gjithashtu e shëndetshme pinte *tamblin,* kushtin e jetës, esencën e këtij planeti.
Ika si i dalldisur nga ndijimet. Verë. Ngjyrat e fushave, diku të blerta diku të arta. Isha plot tallazitje poetike në atë fillim të viteve '70, koha e shkurtër e liberalizmit dhe e shpresave. Nuk e di, atë ditë apo pak ditë më pas, shkrova poezinë *Foshnja në gji,* të cilën më erdhi radha ta botoj për herë të parë, pas dymbëdhjetë vjetësh, në librin tim *Vise me diell.* Më pëlqen kjo poezi, dhe e kam shumë të dashur, si gjënë e vërtetë tek e cila kemi mbërritur në një moment të jetës.
Qysh atëherë koha ka rrjedhur si ujët nën urë, jeta po ashtu, dhe kam menduar shumë gjëra. Kam menduar se Mjedja, ka pasur një përvojë të ngjashme lidhur me *Buzëqeshjen e foshnjës*, si nxitje, si fillim. Ka pasur një takim, një shkëndijë që ka rezultuar me një produkt të përcaktuar për të qenë jashtë skeme. Si çdo poezi e vërtetë, ajo na pëlqen jo duke na entuziazmuar, por duke na bindur, duke na sugjestionuar, duke na lënë në shpirt pa e kuptuar, një pasuri që nuk njeh bjerrje.

15
Unë në bibliotekën time kam tre botime të veprës poetike të Mjedjes (një botim vërtet i mire nuk ekziston), por nuk kam gërmuar ndonjëherë në arkivat e poetëve pasi jeta më pati çuar në disa arkiva tjera. Diku nga mesi i viteve '90 më ra në dorë një botim i Prishtinës i veprës së Mjedjes, Juvenilia. Aty u befasova nga një shënim që na u gjendka mbi kopjen e daktilografuar të poemës *Andrra e jetës*, në Fondin Ndre Mjedja: *shkasin e muer Auktori prej nji nane që mbet e vejë me një vajzë të vogël e kje lanë me banue në jerevi të Dom Ndreut në Kukël*". Ende kjo nuk e vërteton idenë time, por sidoqoftë, ajo nuk qenkesh hamendje në erë! Vallë, kush e bëri këtë shënim dhe, si e dinte ai këtë gjë?
2012






Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Lionel Messi, lojtar i PSG-së: Ëndërroj ta fitojë Ligën e Kampionëve

